

Osmani
Qytetarët do pyeten pas marrëveshjes

Fq.3



RASTI ALMIR ALIU
Kusigerska nuk largohet, gjykimi fillon nga e para

Fq.5



Xhan
ka arritur marrëveshje me "zonjën e vjetër"

Fq.22



Koha

www.koha.mk



Fejsbuku
është në telashe

Fq.13

AKTUALE

Financimi i universiteteve, jo nga studentët



Me shumë autonomi institucionale dhe më tepër liri akademike është njëra prej kërkesave të artikuluar nga përfaqësues të shumtë të branshit akademik. Edhe pse Propozim-ligji për arsim të lartë, i cili vazhdon të jetë në debat publik, ua kthen në masë të konsiderueshme universiteteve autonominë e suprimuar në vitin 2015, prapë se prapë universitetet konsiderojnë se duhet të kenë më tepër autonomi sa u përket programeve...

Fq.6

RAJON

Kosova falënderon shtetet që e kanë njohur pavarësinë

Fq.14

PROFILE

Sekretet e burrit që flet 32 gjuhë

Fq.12



PROJEKTET E LASH MEMBËSHTETJE MAKSIMALE

ART TETOVË, SHOQATA FANTAZMË QË MERR MBI 2.4 MILIONË DENARË



FESTIVALI TRADICIONAL I FËMIJËVE "YLBERI FEST" FITON 80 MIJË DENARË

Lidhja e Artistëve Shqiptarë "Art" Tetovë, është një prej aplikuesve që në Programin Vjetor të Ministrisë ka përfituar mbështetje maksimale për tre projekte në sektorin e muzikës. Nga komuniteti artistik në këtë qytet, të kontaktuar nga KOHA, nuk kanë dijeni as për aktivitetin dhe as për treguesit e suksesit të kësaj shoqate

Fq.4

Ligji që do të parandalojë mashtrimet

Shkup, 15 shkurt - Me shpresë se për tre muaj punë në Gjermani do të fitojë më shumë të holla se për një vjet në Maqedoni, më shumë qytetarë drejtohen të punojnë për disa muaj jashtë shtetit. Punëtorët që kanë fatin të gjejnë një punë sezonale, duke shfrytëzuar edhe njohjet private, që në fund ju paguhet, edhe mund të jenë lumtur, përkundër kompensimit eventual për ndërmjetësimin në punë. Ekzi-

stojnë raste kur ëndrrat për një punë të paguar bëhen realitet, por jo rrallë ndodhin edhe raste të mashtrimeve përmes premtimeve për kontrata pune jashtë vendit, ku qindra qytetarë gënjejnë nga agjencitë që përfitojnë shumën të majme parash nga qytetarët për shërbimet e rrejshme të tyre. Që të parandalohen këto dukuri rekomandohet që qytetarët të bëjnë më shumë kujdes kur bëhet fjalë...

Fq.8



EDITORIAL

KOSOVA, SHTET I
PAPËRFUNDUAR!?

Emin AZEMI

Një gazetar i huaj këto ditë e përshkroi Kosovën me pak fjalë, në prag të 10 vjetorit të pavarësisë së saj: Organizimi i shtetit ka mbetur i papërfunduar. Institucionet janë në duar të një elite politike që janë të prirë për ta pasuruar veten dhe përcjellësit e tyre. Partitë janë të një sistem të vërtet klientelist, ku besnikëria përkthehet në vende punë dhe në pozita.

Ky përshkrim i shkurtër i gjendjes momentale në Kosovë, nuk mund të thuhet se vjen nga një i huaj që nuk i njeh rrethanat. Ose, nuk mund të thuhet se ai është i motivuar nga ndonjë grupim politik që nuk ia do të mirën Kosovës.

Merre si ta marrësh, këtij përshkrimi nuk i mungon qasja racionale dhe çdo kush që mundohet ta shtrembëroj këtë qasje, do të bënte lajthitjen më të madhe të vetvetes dhe të të tjerëve. Vetëm ndonjë strukturë e lidhur me qeveritë, tash e në të kaluarën, mund të sheh optimizëm në rrugën e zhvillimit të Kosovës. Por, pjesa tjetër që është mbi 80 për qind e popullatës, ende vuan pasojat e logjikës partizane, ku i fort i lagjes dhe i katundit bën ligjin, kurse tenderët janë shpërblimi më i mirë për ata që në emër të Kosovës bëjnë biznes dhe largojnë investitorët që të rigjenerojnë ekonominë e vendit.

Treguesit ekonomikë thonë se Kosova ka deficit të lartë tregtar, si pasojë e mungesës së kapaciteteve prodhuese që reflektohet në eksport, i cili është shumë inferior kundrejt importit, kryesisht të produkteve nga Serbia.

Patriotizmi megaloman i politikanëve me alltia që nuk kursejnë rafale fishekësh nëpër synetia e ndeja primitive odash, është i rezervuar vetëm për ndonjë kundërshtar të brendshëm politik, por jo edhe për ekspansionin tregtar të Serbisë, dhe për evazionin fiskal që kryhet në veri të Kosovës. Ka të ngjarë që ky evazion i pakontrollueshëm që ka licencë Beogradi, të ketë ndikuar edhe në evazionin moral të politikanëve në Prishtinë. Gojë të këqija thonë se veriu i Mitrovicës ka vite që është njëfarë Eldoradoje e mangupëve në Prishtinë, të cilët herë vishen në petkun e gazetarëve, herë të politikanëve, e herë të mafiozëve.

Ky klonim i interesave të ngushta klanore të mangupëve të Prishtinës në karta patriotike, ka rrezikuar seriozisht konkurrencën reale të ideve e projekteve, të cilat luftohen ende pa dalur në sipërfaqe.

Dhjetëvjetorin e Pavarësisë së Kosovës do ta festojnë të gjithë, por jo të gjithë do të kenë mundësi të presin miqë, siç po bëjnë politikanët, duke i shndërruar odat e tyre në zyra qeveritare, gjoja në emër të racionalizimit të shpenzimeve publike.

Organizimi i shtetit ka mbetur i papërfunduar, thotë kolegu gazetar që vjen nga jashtë, dhe na vjen të plasim kur ai konstaton se institucionet janë në duar të një elite politike që janë të prirë për ta pasuruar veten.

"Shtet i papërfunduar? Si i bie kjo? Kemi dëgjuar për udhë të papërfunduar, për shtëpi të papërfunduar, për projekt të papërfunduar, por rrallë kemi hasur në sintagmë që asocon në shtet të papërfunduar. Kjo është si të thuash: njeri i papërfunduar.

Merita më e madhe e atyre që duhej ta përfundonin shtetin e Kosovës, si duket ishte të ushqenin rubrikat e rezervuara të shtypit të Beogradit me kronikat për Kosovën ku në të shumtën e rasteve ajo cilësohej si KINSE ose GJOJA shtet.

Meqë Kosova nuk arriti të çlirohet prej armiqve të saj të brendshëm, atëherë ndjellakeqësitë e armiqve të jashtëm ngandonjerë do të na hynin në punë si referenca për të zhgënjyerit që mezi presin të liberalizohen lëvizjet njëdrejtimëshe jashtë vendit.

AS SERBIA NUK E KA PASUR KURAJON QË TË MATET ME FLAMURIN SHQIPTAR!

"Çka ka ndodhur me ty Kryeministër i Kosovës Ramush Haradinaj, çka ka ndodhur me ty President i Kosovës Hashim Thaqi, çka ka ndodhur me ty Kryetar i Kuvendit të Kosovës Kadri Veseli, që po e fyeni kombin tuaj kaq rënd?!"

As Serbia nuk e ka pasur kurajon që të matet me Flamurin shqiptar! Çfarë mesazhi po doni me i dhënë Evropës? Që nuk jemi shqiptar, a që nuk po duam të bashkohemi me Shqipërinë! Po Kosova po këmbëngul që të bashkohet me Evropën e le më me Shqipërinë?! Nëse po doni të thirreni në simbolet shtetërore, atëherë e keni gabim, sepse ato e kanë vendin pranë institucioneve. Në hapësirat tjera ka vullnete të qytetarëve. Këto janë të rregulluara me ligje kudo në Evropë, me një standard.

A po tutni a çka dreqin keni?! Nëse keni bërë keq, kurgja s'ju lanë, kot e shkëlmi flamurin tonë. Njerëzit tuaj të besës, kanë me ju ra në qafë! Me shqiponjën në këmbë, nuk ju mëshiron askush, madje as Serbia! Nuk është zor të kuptohet qëllimi juaj. Këtë e ka kuptuar edhe LVV. Gështenjat duhet ti hiqni me duart tuaja kësaj radhe! Nëse e vendosni aty sërish, ne do ta pranojmë arsyetimin, se e keni hequr për ta zëvendësuar me një të ri!", shkruan në profilin e tij në Facebook, nipi i Idriz Seferit, Nijazi Idrizi.

DASHURIA QË LIDH NJERËZIT

"Çdo njeri që takon në jetë, ke takuar një krijesë të veçantë nga të tjerët, individ quhet, sepse është i veçantë prej gjithë njerëzve të botës në mendime, në bindje, në fizionomi, pra, nuk është i njëjtë me askënd në botë dhe, me takimin e kujtdo, ke takuar një krijesë të re dhe duhet pranuar si e tillë, prandaj nga çdokush mund të mësosh diçka të re. Ajo që i lidh njerëzit është dashuria reciproke dhe besimi nxit mendimet e mira, që mund të krijojnë afrimin shpirtëror, krijimin e shoqërisë së shëndoshë, që lidhur me këtë i përshtatet fjala popullore: "Nga të shkosh, nga një shtëpi ndërtoje", shkruan në profilin e tij në Facebook, teologu Hasan Baftijari.

THIRRJE PËR PROTESTE

Protesta do të mbahet në Shkup në Sheshi Gjergj Kastrioti Skënderbeu në datën 23/02/2018 në ora 13.00. Protesta mbahet në shenjë revolte kundër të gjithë proceseve, sipas ne, të fabrikuar që nga viti 2001 deri në ndërrim të pushtetit pas zgjedhjeve parlamentare.

Protestojmë kundër aktgjyqimeve të fabrikuar në bazë të dëshmitarëve të fshehur - shpifur dhe kundër dhjetëra shkeljeve procedurale për sjelljen e vendimeve - dënime me burg të përjetshëm për dhjetëra shqiptarë. Kërkojmë rigjykim për rastin 'Alfa', 'Lagja e Trimave' dhe shumë raste tjera. Moto e protestës: E vërteta në shesh, në burg dergjen njerëz-prindër të pafajshëm", shkruan në Profilin e tij në Facebook, përfaqësuesi i Këshillit të familjarëve të të burgosurve në procese të fabrikuar, Shpëtim Pollozhani, njëherësh kryetar i Shoqatës së të Burgosurve dhe të Dëmtuarve Politik Shqiptarë.

MEDIACitate

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) ka njoftuar se në sulmet gjatë vitit të kaluar në Afganistan kanë humbur jetën mbi 3.400 persona. Në një deklaratë nga OKB-ja thuhet se në sulmet e kryera gjatë vitit 2017 në pjesë të ndryshme të shtetit kanë humbur jetën 3.438 persona ndërsa 7.015 të tjerë janë plagosur. Në mesin e atyre që kanë humbur jetën si pasojë e sulmeve 359 janë gra dhe 861 fëmijë. Në deklaratë thuhet se talebanët janë përgjegjës për 42 për qind të sulmeve dhe se prej 10 për qind të tyre përgjegjës është organizata terroriste DEASH, 16 për qind forcat qeveritare, 2 për qind forcat e huaja dhe pjesa tjetër nga grupet terroriste. Më tej thuhet se 23 civilë e kanë humbur jetën si pasojë e sulmeve me predha mortaje nga trupat kufitare të Pakistanit. Numri më i madh i vdekjeve civile ka ndodhur duke filluar nga kryeqyteti i Afganistanit, Kabul, pastaj në provincat Farah, Helmand, Kunduz dhe Uruzgan. Në sulmet ndaj objekteve fetare të organizatës terroriste DEASH në vitin 2017 ka një rritje prej 50 për qind dhe se numri i përlëshjeve me organizatat terroriste është zvogëluar për 19 për qind.

(Anadolu Agency, 15 shkurt)

Kam parandier që do të ketë viktima në veri të Mitrovicës, në këtë pjesë të kriminalizuar të Kosovës, e cila është fuqishëm e lidhur ngushtë me Beogradin, sepse shumica e tyre janë në SNS. Edhe Oliveri këtë e ka parandjerë, prandaj pati thënë se "ka mbetur vetëm edhe të më vrasin". Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq mi ka borxh 600.000 euro. Kurse, në Serbi jetohej më keq se ndonjëherë më parë dhe mentorët e Vuçiqit tentuan të më vrasin mua dhe familjen time, jam i rrezikuar. Krejt këto komente i ka thënë për në një intervistë për KosovaPress, ish-deputeti i Parlamentit të Serbisë, Sasha Mirković, i cili ka shpallur qëndrimet e tij rreth gjendjes së përgjithshme aktuale në Serbi dhe presidentit të saj, Aleksandar Vuçiq. Ai foli për qasjen e gabuar të Beogradit zyrtar ndaj serbëve të Kosovës, përmirësimin e raporteve mes Prishtinës dhe Beogradit, ndikimin rus, vrasjen e Oliver Ivanoviçit, si dhe për atentatin ndaj tij nga ana e pushtetit aktual në Serbi.

(KOHA Ditore, 15 shkurt)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

KU KALON VIJA NDARËSE E 1913-S?

Me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër me 1913 (foto) ku u caktua kufiri i Shqipërisë, vija ndarëse takoi në Malësinë e Gjakovës. Pjesa më e madhe e saj mbeti brenda kufijve të Shqipërisë së pavarur, por pjesa tjetër e Malësisë vazhdon jashtë kufirit aktual shtetëror të Republikës së Shqipërisë, në disa vendbanime afër Gjakovës dhe Junikut. Në jug shtrihet deri në Liqenin e Fierzës. Brenda Malësisë së Gjakovës

shtrihen bajraqet historike të Krasniqes, Gashit dhe Bytyçit. Malësia e Gjakovës shtrihet në lindje të Alpeve Shqiptare. Në kufijtë e sotëm administrativ të Shqipërisë kjo trevë i takon rrethit të Tropojës. Malësia e Gjakovës shquhet nga lumenjtë e saj, më i rëndësishmi është lumi i Valbonës. Në veriperëndim të saj mbizotëron relievi kryesisht kodrinor, relievi malor, gropat e fundosura, nga të cilat më e madhja është ajo e Tropojës.

Osmani pohoi se nga shtatë pikat në negociata, tre janë më të lehta, ndërsa katër më të vështira, megjithatë shtoi ai, nëse tani fillojmë të debatojmë dhe dërgojmë porosi, ai është model i mossuksesit

ZËVENDËSKRYEMINISTRI OSMANI KRITIK NDAJ DEBATIT NË MEDIA

QYTETARËT DO PYETEN PAS MARRËVESHJES

nion. Ata që mundohen tani të imponojnë tema të ndryshme për këtë çështje e që nuk janë thelbësore, mundohen ta pengojnë procesin dhe besoni se ka forca të cilat nuk duan që Maqedonia ta mbyllë çështjen dhe të arrijë suksese", potencoi Osmani. Ndërkaq, po të enjten pas takimit me ambasadorin e Bosnjës dhe Hercegovinës, Lepa Babiq, zëvendëskryeministri Bujar Osmani foli për klimën e mirë

ndërfqinjësore që Qeveria e re ka krijuar deri më tani. "Gjatë takimit së bashku ranë dakord se Strategjia e zgjerimit të KE-së paraqet një rën nga iniciativat më të rëndësishme të Komisionit Evropian për këtë rajon, sepse në mënyrë të drejtpërdrejtë tregon se Bashkimi Evropian kthen fokusin në rajon, ndërkaq procesi i zgjerimit me vendet e Ballkanit Perëndimor-sërish është lart në agjendën e Bashkimit Evropian.

Kemi momentum jashtëzakonisht pozitiv, me kryesimin e Bullgarisë me Këshillin Evropian, që do të vazhdojë me kryesimin nga ana e Austrisë dhe më pas edhe me Rumaninë, që janë mbështetës të fortë të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian, si dhe që kanë interes të pashmangshëm për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian", theksoi Osmani. Ai ka folur edhe për çështjen e Ligjit për gjuhët duke thënë se po përgatisin detajet e fundit për procedimin e këtij ligji. "E dini se kryetari i Parlamentit dhe një pjesë e deputetëve janë në Britani të Madhe dhe presim ata të kthehen dhe besoj shumë shpejt do ta kalojmë ligjin", ka thënë Osmani. Lidhur me atë nëse ka bisedime me VMRO-në në këtë temë, Osmani thotë se ato zhvillohen ndërmjet LSDM-së dhe partisë së Mickoskit. "Ekziston një komunikim mes LSDM-së dhe VMRO-së, ne jemi në dijeni për këtë dhe jemi të informuar në vazhdimësi me qëllim të krijohet një fundament i besimit të ndërsjellë, pastaj do të formalizohet ai debat, por është e vërtetë se ndoshta nuk është shumë publike, por ekzistojnë grupe pune të dyja partive politike që trajtojnë çështjet e Planit 3-6-9 dhe kur të krijohet një besim bazik, do të inkuadrohen edhe partitë tjera dhe ta formalizojmë këtë debat pozitë-opozitë", ka thënë Osmani.

KATËR PIKAT DISKUTABILE TË NIMICIT

Nga ana tjetër, kryeministri Zoran Zaev tha të enjten se nga shtatë pikat e planit të ndërmjetësuesit Metju Nimiç, për katër prej tyre ende nuk marrëveshje mes palëve. "Ndërmjetësuesi Nimiç e udhëheq procesin, ai i di në thelb punët të cilat mund të kalojnë, si dhe ato që nuk mund të kalojnë te njëra ose te tjetra palë. Me rëndësi është të ndërtohet besim mes dy palëve në funksion të zgjidhjes së problemit. Mua më vjen mirë që janë hapur në thelb të gjitha çështjet e



hapura. Nëse nisemi nga shtatë pozitat, të cilat ishin pikat nisëse në biseda, e di se tani janë zvogëluar në katër pozita, tre janë larguar. Unë besoj se me politikën e Qeverisë së re shumë shpejtë do të mund të largohen edhe pozitat tjera", tha kryeministri Zoran Zaev. Ai shtoi se me siguri për tre pikat që janë marrëveshje kanë qenë çështjet më të lehta, por siç theksoi Zaev, kjo duhet të jetë sinjal për ne dhe inkurajim për palën greke se është e mundur të gjendet zgjidhje.

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 15 shkurt - Zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, të enjten ishte kritik ndaj debatit në media lidhur me çështjen e zgjidhjes së emrit më Greqinë. Siç theksoi ai, në momentin që palët do kenë pajtueshmëri - do ti bëjnë publike opsionet për emrin e shtetit. "Në asnjë mënyrë nuk do t'i ndihmojmë procesit përmes debatit në media. Prandaj duhet ta mbajmë këtë debat në suaza të ekupeve negociuese, ndërsa në momentin kur të kemi në parim ndonjë pajtueshmëri, atëherë mund të dalim në opinion dhe të kërkojmë mendim të qytetarëve edhe nga shtresat e tjera shoqërore", tha zëvendëskryeministri Bujar Osmani para hapjes së Konferencës nacionale trilaterale "Eurointegrimet e Maqedonisë dhe e ardhmja e Bashkimit Evropian". Ai pohoi se nga shtatë pikat në negociata, tre janë më të lehta, ndërsa katër më të vështira, megjithatë shtoi ai, nëse tani fillojmë të debatojmë dhe dërgojmë porosi, ai është model i mossuksesit. Zëvendëskryeministri Osmani tha më tej se ka forca që ende punojnë kundër mbylljes së çështjes së emrit. "Nuk them se në një moment nuk do të dalim me të gjitha opsionet, por procesi ende nuk është në nivelin e duhur që të mundemi ta ekspozojmë në opi-

INTELEKTUALËT KUNDËR MOSPËRFILLJES SË ELEMENTIT SHQIPTAR PËR EMRIN

MEMORANDUM PËR SENSIBILIZIMIN E OPINIONIT PËR EMRIN

Mehmeti njofton se grupi do të kontaktojë partitë politike për të parë qëndrimet e tyre, por siç shton ai, partitë nuk do të kyçen në përpilimin e Memorandumit



Shkup, 15 shkurt - Jemi kundër hestitjes së faktorit politik shqiptar dhe për ndërtimin e një qëndrimi të shqiptarëve për këtë çështje - si dëshmi historike se ne jemi këtu në tokën tonë dhe çfarëdo emri pa pajtimin tonë, do të jetë i papranueshëm. Kështu thotë për gazetën KOHA, dr. Abulla Mehmeti, iniciator për formimin grupit nismëtar për

të sensibilizuar opinionin rreth mospërfilljes së elementit shqiptar në bisedimet dypalëshe për emrin. "Partitë e shqiptarëve që janë në pushtet, por edhe ato opozitare, në njëfarë mënyre janë pajtuar duke marrë pjesë në pushtet, që në emër të tyre të flet Qeveria, përkatësisht

Ministria e Punëve të Jashtme e Maqedonisë, me pëlqimin e drejtuesve të partive shqiptare. Për momentin jemi vetëm një grup nismëtar nga intelektualë, pa parti dhe organizata pas kësaj ideje. Qëllimi është që përmes një memorandumit të sensibilizojmë opinionin e

gjërë dhe sidomos opinionin ndërkombëtar lidhur me qëndrimin tonë për këtë çështje kaq me rëndësi për vendin dhe për shqiptarët", thotë Mehmeti. Ai njofton se grupi do të kontaktojë partitë politike për të parë qëndrimet e tyre, por siç shtoi Meh-

meti, partitë nuk do të kyçen në përpilimin e Memorandumit. "Ky grup ka për detyrë të marrë qëndrimet e të gjithë faktorit shqiptar, do të kontaktohen të gjithë faktorët, për të marrë qëndrimet e tyre rreth kësaj çështje, por nuk do të jenë të kyçura në punën e këtij Këshilli dhe në hartimin e Memorandumit. Kjo, për shkak se partitë dhe disa subjekte të tjera veç e kanë treguar vetveten në lidhje me këtë çështje", thotë Abdullah Mehmeti. Ai shton se në përgatitjen e Memorandumit do të konsultohen me ekspertë vendor ashtu dhe me ata ndërkombëtar. "Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me ekspertë ndërkombëtarë dhe vendës, që kjo çështje të parashtrahet në formën sa më të qartë, më përmbajtësore dhe të jetë sa më gjithë përfshirëse", thotë Mehmeti. (F.R)



Kujtim Saliu me LASH Art Tetovë, fiton 2.4 milionë denarë



Festivali tradicional i fëmijëve "Ylberi Fest" fiton 80 mijë denarë

PROJEKTET E LASH ME MBËSHTETJE MAKSIMALE

Lidhja e Artistëve Shqiptarë "Art" Tetovë, është një prej aplikuesve që në Programin Vjetor të Ministrisë ka përfituar mbështetje maksimale për tre projekte në sektorin e muzikës. Nga komuniteti artistik në këtë qytet, të kontaktuar nga KOHA, nuk kanë dijeni as për aktivitetin dhe as për treguesit e suksesit të kësaj shoqate

ART TETOVË, SHOQATA FANTAZMË QË MERR MBI 2.4 MILIONË

Koha

Evis HALILI

Shkup, 15 shkurt - Plot dy milionë e katërqind mijë denarë janë akorduar nga buxheti i Programit të Kulturës për këtë vit për të mbështetur tre projekte të një shoqate që njihet aspak për veprimtarinë në sferën e kulturës, madje as anëtarësinë e saj. Bëhet fjalë për Art Tetovë, Lidhjen e Artistëve Shqiptarë - e cila është një prej aplikuesve që në Programin Vjetor të Ministrisë ka përfituar mbështetje maksimale për tre projekte në sektorin e muzikës, pa ndonjë diferencë të madhe mes shumës së kërkuar dhe asaj të miratuar për realizimin e projektit. Nga komuniteti artistik në këtë qytet të kontaktuar nga KOHA nuk kanë dijeni, as për aktivitetin dhe as për treguesit e suksesit të kësaj shoqate e cila ka siguruar shuma të mëdha. Informacionet e vetme për LASH - Art Tetovë mund të gjenden vetëm në Regjistrin Qendror, ku si kryetar i saj qëndron Kujtim Saliu (me adresë banimi në Kërçovë). Saliu është edhe gjithashtu edhe anëtar i vetëm i shoqatës. Mbetet indikative për këtë shoqatë sesi do të menaxhohet dhe ku do të shpenzohet paratë e akorduara. Një prej aktiviteteve të saj deklarohen se do ta realizojë në ambientet e saj, Art, vendndodhja, pasi sipas adresës që figuron në Regjistrin Qendror, gjendet një apartament banimi dhe jo selia e shoqatës, në të cilin pretendohet se do të realizohet projekti "Duke njohur vlerat tona" (janë kërkuar 930 mijë denarë dhe janë miratuar 900 mijë). Një tjetër projekt është Festivali i Muzikës Shqiptare Polifest (që do të zhvillohet në ambientet e Qendrës së Kulturës Tetovë, për të cilin janë ndarë 800 mijë denarë, ndërsa 700 mijë denarë të tjerë janë ndarë për 21 nominimet për shpërblimet Art 2017 (për të njëjtin festival).

MINISTRIA E KULTURËS: DENONCONI ABUZIMET

Pas reagimeve publike në lidhje me disa projekte individuale dhe vendime në Programin Vjetor të publikuar dhe rezultatet e Planit Vjetor për Propozime për Financimin e Projekteve të Interesit Kombëtar në Kulturë për vitin 2018, Ministria e Kulturës përmes një lajmërimi i ka apeluar opinionit publik dhe të gjithë atyre që kanë informacion ose tregues të shkeljeve apo abuzimeve, që t'i dorëzojnë në Ministri. "Përcaktimi ynë i qartë është se proceset e vendimmarrjes janë plotësisht transparente, të drejta dhe objektive, në përputhje me parimet, kriteret dhe rregulloret e aplikacioneve konkurruese. Në mënyrë të vendosur mbajmë qëndrim se nëse ka indikacione për parregullsi në procesin e aplikimit dhe vendimin, ose në qoftë se persona të caktuar apo subjekteve të përfshira të



nepotizmit, korrupsionit, klientelizmit apo praktika të tjera të paligjshme, Ministria është e gatshme që menjëherë të rishikojë këto raste, dhe në qoftë se është gjetur përgjegjësi, do të kryejë procedura disiplinore dhe të tjera në përputhje me ligjin", thuhet në reagimin e Ministrisë. Koha e veprimtarisë së paligjshme dhe joprofesionale ka përfunduar dhe praktikën e tilla zëvendësohen nga praktikën e të punuarit me përgjegjësi. Ashtu si në punën tonë të mëparshme gjatë muajve të fundit, Ministria i bën transparente të gjithë dokumentacionin në dispozicion të mediave, publikut dhe autoriteteve kompetente. Në të njëjtën kohë, ne ftojmë të gjithë ata që kanë ndonjë informacion në lidhje me këtë për të informuar Ministrinë e Kulturës, thuhet në reagimin e këtij institucioni.

I pyetur nga KOHA, sekretari shtetëror në Ministrinë e Kulturës, Valmir Aziri, lidhur me projektet dhe shumatat që i janë ndarë kësaj shoqate, dhe të tjerave, individëve..., lidhur me kredibilitetin, besueshmërinë e tyre, thotë se nuk është detyrë e Ministrisë që të verifikojë të dhënat e tyre. Thjesht miratohen projektet, të cilat janë vlerësuar nga ana e komisionit se duhet të miratohen.

"Ju garantoj se të gjitha këto shoqata kanë konkurruar edhe më parë, por kanë pasur buxhet të limituar dhe nuk kanë dalë në pah. Si guxojmë të paragjykojmë projektet që ende as nuk janë nënshkruar dhe as që kanë nisur që të realizohen..."

Ne mund të flasim në fillim të vitit të ardhshëm kur do të vëmë në tavolinë ndarjen e mjeteve dhe realizimin e projekteve. Deri atëherë nuk mund të marr guximin të paragjykojmë asnjë projekt që i janë ndarë mjete nga Ministria e Kulturës, se si do të jetë fundi i tij", thotë Aziri, duke mbrojtur vendimin për ndarjen e 2.4 milionë denarë kësaj shoqate.

Qëndrim i Azirit është në kontrast me atë të anëtarit shqiptar i këtij komisioni, Rami Mustafa, i cili ka deklaruar se përzgjedhja e shumave dhe projekteve fituese është bërë duke shpërfillur vlerësimet profesionale. Shumë shoqata e individë kanë konkurruar duke marrë

fonde të mëdha, të tjerë shuma disa herë më të vogla nga sa kanë kërkuar. Ka shumë raste kur për financimin e projekteve të ngjashme, janë ndarë shuma të ndryshme. Për një koncert deri në 300 mijë, 600 mijë denarë, për një festival mbi një milion denarë, e për të tjerë 80 mijë denarë, si "Ylberi Fest". Sipas Azirit, Ministria e Kulturës nuk është e obliguar që të sponsorizojë evente private, edhe pse të tilla janë edhe aktivitetet e ART Tetovë me 45 mijë euro. "Por mund edhe të debatohet nëse një festival mund të ngrihet në nivel nacional", shton ai.

I pyetur se nëse është verifikuar se kujt do t'i besohen këto shuma të

mëdha dhe nëse do të vihen vërtet në funksion të artit dhe kulturës, Aziri thotë se do ta tregojë koha. Sipas tij, mes shoqatave figurojnë edhe emra të njohur e më pak të njohur, pasi iu është dhënë shansi organizatave të reja, artistëve të rinj, për të mos krijuar monopol të shoqatave që fitojnë çdo vit.

"Në gjithë këtë buxhet të madh, ndoshta kemi bërë edhe hapa fals, pasi nuk mund të them që është më i miri i ndarë, por edhe më i madhi që kemi ndarë për shqiptarët. Dhe në këtë moment që e kemi arritur debati bëhet që hajde të paragjykojmë ato që i kanë marrë, që s'është e drejtë", thotë Aziri.

Megjithatë, reagimet negative në opinion mbeten. Nga kjo ndarje e mjeteve janë distancuar edhe vetë anëtarët shqiptarë të komisioneve që akuzuan për padrejtësi dhe joprofessionalizëm. Mbetet pa përgjigje pyetja se kush atëherë vendosi se sa mjete dhe ku do të përfundojnë mjetet e Ministrisë së Kulturës.

KËTU DO TË DUHEJ TË IMPLEMENTOHET "PROJEKTI" 900 MIJË DENARËSH

Adresa me numër Rruga "180", nr.70-32/25-Tetovë, ekziston, por është një banesë në një bllok ndërtesash, pa ndonjë shënim se këtu diku, ekziston Shoqata e Artistëve Shqiptarë "Art". Asnjë nga banorët, por edhe përgjegjësit juridik të banesave nuk di të tregojë nëse në ndonjërin nga këto komplekse banesore ushtron aktivitet ndonjë shoqatë e artistëve shqiptarë, ndërsa një banor thotë vetëm se ekziston një banesë e zbrazur - e dhënë me qera nga një person nga Kërçova. "Megjithatë, aktivitetet ose lëvizjet të njerëzve nuk kemi parë,



përveç herë pas herë të atij nga Kërçova që e ka banesën, më duket me qera". Në ndërkohë, po në këtë adresë - në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë është e regjistruar që në vitin 2008 kjo shoqatë e që nga Ministria e Kulturës ka fituar tre projekte në vlerë prej 2.400.000 denarë. Në adresën e "shoqatës" (banesë pa shënim) për të cilën askush nuk ka njohuri për aktivitete kulturore, sipas rezultateve të Programit të Ministrisë së Kulturës, do të duhet të realizohet projekti "Ti njohim vlerat tona", me 900.000 denarë.

Nesër lexoni: Kush është bashkëpunëtori i afërt i sekretarit shtetëror Valmir Aziri që fitoi mjete nga Ministria e Kulturës?

PROCEDOHEM NGA FILLIMI RASTI I ALMIT ALIUT



KUSIGERSKA NUK LARGOHET, GJYKIMI FILLON NGA E PARA

Përkundër faktit se gjykimi për rastin Almir Aliu do të nisë nga fillimi, prokurorja e lëndës, Suzana Kusigerska, edhe më tutje do ta përfaqësojë këtë aktakuzë

Koha

Omer XHAFERI

Kumanovë, 15 shkurt - Vrasja me paramendim e vogëlushit Almir Aliu, në korrik të vitit 2016, nuk ka qenë dëshmi e mjaftueshme që gjykata e Kumanovës, brenda një viti e më tepër të shpallë aktgjykim kundër dorasit Boban Iliq. Seancat e anuluar kohë pas kohe si dhe mos marrja parasysh e provave dhe dëshmitëve të propozuara nga pala mbrojtëse e familjes Aliu ka ndikuar që ky proces gjyqësor të zvarritet pafundësisht, me çka të enjten u soll vendimi për të filluar nga e para. Sipas avokatit Asmir Ali-spahiç, përmbushja e afatit ligjor prej 90 ditësh, prej kohësh kur është zhvilluar seanca e fundit, ka qenë faktori kryesor se pse ky proces do të nisë nga fillimi.

Me hapjen e procedurës së re gjyqësore kundër Iliqit, pala mbrojtëse e të dëmtuarave për gazetën KOHA ka theksuar se do të parashtrijë një listë të re me dëshmi.

Përveç këtyre provave, avokatët kanë thënë se do të kërkojnë edhe njëherë prononcin e familjarëve të dorasit, gjegjësisht vëllait të tij, Bojan Iliq dhe të dashurës Tanja Dimkovska. Paralelisht me këto dëshmitarë, mbrojtja e familjes Aliu edhe njëherë do të propozojë dëgjimin e dëshmitarëve okular Llokman Kadria, Fuad Ibishi dhe Mehmet Jahja, kërkesë kjo e cila u refuzua gjatë gjykit paraprak nga gjykatësja Maja Denkovska. Përkundër faktit se gjykimi për rastin e 4-vjeçarit Almir Aliu do të nisë nga fillimi, prokurorja e lëndës, Suzana Kusigerska edhe më tutje do ta përfaqësojë këtë aktakuzë. Reagimet e shumta të opinionit, avokatëve dhe familjarëve që kjo prokurorë të largohet nga kjo lëndë, nuk kanë hasur në mirëkuptim nga organet relevante në prokurori. Tendanca për ta rikualifikuar këtë vepër penale nga shkalla e "vrasjes", në një vepër për kundërvajtje të llojit "aksi-

dent me pasojë vdekje", ngjalli neveri të shumë qytetarë dhe profesionistë të fushës penale. Dëshmitë e publikuara në opinion ku shihet vrasësi Iliq se si me shpejtë-

Dëshmitë e publikuara në opinion ku shihet vrasësi Iliq se si me shpejtësi të madhe, me veturën e tij, e godet për vdekje Almirin e vogël dhe dy prindërit e tij, nuk japin hapësirë për një diskutim më të gjerë për veprën e kryer



lëndë t'i dorëzohet Prokurorisë Shtetërore për dhënie të vlerësimit lidhur me kualifikimin e aktakuzës.

IDRIZOVA ME DREJTOR TË RI

Dimov emërohet në vend të Mahmutit

Shkup, 15 shkurt - Kuadri i Aleancës për Shqipëtar, ish drejtori i burgut të Idrizovës, Qerim Mahmuti, edhe zyrtarisht nuk është më udhëheqës i burgut më të madh në Maqedoni. Me vendim të Qeverisë, këtë Idrizovën do ta drejtojë Antonio Dimov, sekretar i Partisë Liberale të Maqedonisë, parti kjo në koalicion me LSDM-në. Në biografinë e Dimov, të publikuar në vendimin e Qeverisë, shihet qartë i njëjti nuk disponon me ndonjë përvojë në këtë sferë. Ekonomisti i diplomuar në vitin 1999 në Prilep, në biografinë e tij, mes tjerash ka theksuar se për herë të parë si këshilltar ka punuar në kompaninë nga Velesi "Brako", tashmë pronë e zëvendëskryeministrit për çështje ekonomike, Koço Angjushev. Në këtë vend



pune, ai ka punuar për pesë vite të plota. Më pas, ka punuar në kompaninë "Fersped", pronë e Shterjo Nakovit. Njëherësh, Dimov ka nënvizuar se për më tepër se tre vite ka punuar edhe në Toronto të Kanadës. Në pozitën e drejtorit të Idrizovës, sekretari i PLM-së vjen pas miratimit dhe zbatimit të Ligjit për amnisti, me çka mbi 600 të burgosur nga burgu i Idrizovës pritet të dalin në liri. Kushtet në pothuajse të gjitha burgjet e Maqedonisë janë në gjendje të mjerueshme. Megjithatë, hapësira dhe burgu i Idrizovës gjithsesi ka qenë pjesë më shumë raporteve vendase dhe atyre ndërkombëtare, duke potencuar se risocializimi i të dënuarve në këto rrethana nuk është i mundshëm. (O.Xh)

KRONIKË

Vret gruan me çekan para fëmijëve

Pas një zënke familjare B.A. (54) nga Koçani mbrëmë ka vrarë bashkëshorten e tij L.A. (44) me një çekan para dy fëmijëve të tyre, ndërsa pas krimit është hedhur nga çatia e shtëpisë duke u vetëvuar. Ai e ka lënduar edhe vajzën e tij, e cila ka tentuar t'i ndihmojë nënës. Vdekjen tek dy personat e kanë konstatuar ekipe të ndihmës urgjente, ndërsa ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer prokurori publik nga Koçani.

Nuk u jep pagën, babë e nanë rrahin 24-vjeçaren

24-vjeçarja tetovare me initiale S.XH ka denoncuar dhunë familjare nga prindërit e saj, të cilën e kanë kryer rreth orës 22.00 dje. Fillimisht në dhomën e saj ka hyrë nëna e saj dhe ka kërkuar nga ajo që t'ia jepte rrogën, ndërsa S.XH ka refuzuar një gjë të tillë. Më pas, nëna ka filluar ta tërheq për flokësh, përderisa babai i saj me grushta e ka goditur në kokë dhe trup duke i shkaktuar lëndime të dukshme. Pak më vonë, prindërit me initiale M.XH (44) dhe M. XH 41-vjeçar janë thirrur në stacionin policor në Tetovë. Po punohet në zbardhjen e plotë të rastit dhe do të pasojë padi adekuate.

Dhunë familjare në Gostivar

38-vjeçarja nga Shkupi me initiale A.E, e cila përkohësisht ka qëndruar në Gostivar, të mërkurën mbrëmë ka denoncuar sulm fizik nga 23 vjeçari me initiale J.H nga fshati Zdunjë i Gostivarit me të cilin ka qenë në një lidhje dashurie. I denoncuari gjatë ditës disa herë ka hyrë dhe ka dalë nga banesa e saj, në të cilën ka qëndruar me qera, pas çka rreth orës 18.30 minuta e ka sulmuar përderisa ka qenë në hyrje të ndërtesës së banimit, e ka shtrirë për tokë dhe disa herë e ka goditur me grushta në kokë dhe trup, pas çka për pasojë - ka marrë lëndime të dukshme. A.E është dërguar në spitalin e Gostivarit ku i është ofruar ndihma mjekësore. Sulmuesi J.H është thirrur në stacionin policor të Gostivarit dhe po punohet në zbardhjen e plotë të rastit pas çka do të pasojë padi adekuate.

Helmohet me alkool 15-vjeçari nga Gostivari

Të mërkurën mbrëmë, 15 minuta pas mesnate, në repartin e Ndihmës së Shpejtë në Gostivar është sjellë një 15-vjeçar nga Gostivari, i cili është helmuar me një sasi të madhe alkooli. Për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, fillimisht i është ofruar ndihma mjekësore në spitalin e Gostivarit dhe më pas me urgjencë është transferuar për në Klinikat e Shkupit. Po punohet në zbardhjen e motiveve, rrethave dhe gjithçkaje tjetër që ndërlihet me helmimin me alkool të minorit nga Gostivarit. (U.H)

UNIVERSITETI "NËNË TEREZA" DËRGON
VËREJTJET DHE SUGJERIMET

FINANCIMI I UNIVERSITETEVE, JO NGA STUDENTËT

Autonomia, financimit dhe standardizimi i kriterëve janë tematikat në të cilat Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup ka grupuar vërejtjet dhe sugjerimet për Propozim-ligjin e arsimit të lartë

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 15 shkurt - Me shumë autonomi institucionale dhe më tepër liri akademike është njëra prej kërkesave të artikuluar nga përfaqësues të shumtë të branshit akademik. Edhe pse Propozim-ligji për arsim të lartë, i cili vazhdon të jetë në debat publik, ua kthen në masë të konsiderueshme universiteteve autonominë e suprimuar në vitin 2015, prapë se prapë universitetet konsiderojnë se duhet të kenë më tepër autonomi sa u përket programeve studimore apo ndryshimeve në kurrikulat e atyre programeve.

Por jo më pak diskutabile për ta është edhe çështja që lidhet me modelin e financimit, si dhe me mënyrat e avancimit të profesorëve nga njëra anë dhe në anën tjetër - emërimin të anëtarëve të këshillave të ndryshme. Të paktën në këta tre tematika mund të grupohen të gjitha sugjerimet dhe vërejtjet që ka Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup lidhur me këtë Propozim-ligjin. Të njëjtat, UNT ia ka adresuar Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës ditë më parë, pasi propozimet ishin analizuar dhe shqyrtuar në nivel të stafit akademik. Rektori Azis Pollozhani tregon se vërejtjet e UNT-së konsistojnë kryesisht në tre grupe dhe që kanë të bëjnë me çështjet e autonomisë, financimit dhe standardizimit të kriterëve për mënyrën e marrjes së thirrjeve shkencore.

"Grupi i parë i vërejtjeve tona ka të bëjë me kërkesën për autonominë më të madhe të universiteteve. Qëllimi është që të mund të ndryshojmë më shpesh kurrikulat, varësisht nevojave të dhe tregut. Nuk mundet që në çdo pesë vjet të mos ndryshojë asnjë lëndë në programin e akredituar studimor në kohën kur tregu i punës kërkon më shumë fleksibilitet, i cili imponohet nga nevoja e reja që nxjerr



AZIS POLLOZHANI

Kur financimi i universiteteve dhe të ardhurat e profesorëve lidhen kryesisht me të ardhurat që grumbullohen nga pagesat e studentëve, atëherë universitetet vihen në pozita vulnerable karshi studentëve dhe cilësisë së arsimit. Me fjalë të tjera, krijohet një vegës e cila e dëmton cilësinë

tregu vazhdimisht", pohon ai. Me Propozimet për ligjin e ri të arsimit të lartë, akreditimet e programeve studimore ofrohen të bëhen në çdo pesë vjet dhe e parë nga këndvështrimi i nevojave që kanë universitetet për përshtatje me kërkesat e tregut, modeli i ofruar duket tepër statik, apo siç shprehet Pollozhani, "nëse këtë duhet ta bëjmë vetëm një herë në pesë vjet, akreditimet nuk i shërbejnë as përshtatjes së universiteteve dhe as studentëve". Lidhur me modelin e financimit e që sipas Propozim-ligjit në fjalë, universitetet duhet të sigurojnë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit nga të ardhurat vetanake, respektivisht nga page-

UNIVERSITETET SHQIPTARE DORËZOJNË ANKESAT

Sikurse i kemi prezantuar javë në parë, vërejtjet e tyre i kanë dërguar në MASH edhe Universiteti i Tetovës (UT) dhe Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL). Nga UT kanë kërkuar që të definohet qartë formula e financimit të universiteteve sipas modeleve që mbështeten në numrin e studentëve, ndërsa nga UEJL kërkojnë të nënvizohet statusi i tyre "publik-privat jofitimprurës". Ata kërkojnë gjithashtu rishqyrtimin e koncepteve të akreditimeve si dhe rishikimin e balancave midis organeve administrative, drejtuese dhe profesionale në institucionet e arsimit të lartë, në kuptim të kompetencave dhe llogaridhënies. Vetëm kështu, sipas UEJL-së, mund të sigurohet niveli adekuat i funksionalitetit, transparencës dhe përgjegjësisë të qarta. Nga UT kërkojnë në mënyrë të veçantë modelin e financimit të universiteteve nga ana e shtetit duke përdorë numrin e studentëve si kriter bazë.

sat e studentëve, bazuar në vërejtjet e UNT-së, kjo formulë do të vendos universitete në pozita vulnerable. Prandaj, kur janë në pyetje universitetet publike, rrogat e profesorëve duhet të sigurohen tërësisht nga shteti.

"Kur financimi i universiteteve dhe të ardhurat e profesorëve lidhen kryesisht me të ardhurat që grumbullohen nga pagesat e studentëve, atëherë universitetet vihen në pozita vulnerable karshi studentëve dhe cilësisë së arsimit. Me fjalë të tjera, krijohet një vegës e cila e dëmton cilësinë", sqaron rektori i këtij universiteti. Pollozhani është i mendimit se duhet të rishqyrtohet mirë çështja që ka të bëjë me mënyrën e financimit të universiteteve, aq më tepër që në Maqedoni ka kategori të ndrysh-

me të universiteteve. Me disa korigjime në nenet që rregullojnë këtë çështje, rektori i UNT-së është i mendimit se mund të vihet deri në një model më të pranueshme për të gjithë. Në këtë pikë, nga UNT kërkojnë që të korigjohet konvertimi i kredive të studimit në të holla. Konkretisht, kërkojnë që ky konvertim të mos jetë i njëjtë për të gjitha drejtimet studimore. Sepse, sikurse sqaron Pollozhani, nuk është korrekte që kreditë të vlerësohen njëllë, pra të kenë të njëjtin çmim si ato të fakulteteve të shkencave teknike apo mjekësore me kreditë që marrin studentët në fakultetet e shkencave shoqërore. Grupi i tretë i vërejtjeve ka të bëjë me standardizimin e mësimdhënies në universitete, apo kriteret e avancimit.

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI EUJL-UP

Në jubileun e 10 vjetorit të Pavarësisë së shtetit të Kosovës dhe në 48 vjetorin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", dje në Prishtinë u firmos Memorandum bashkëpunimi midis këtij universiteti dhe Universitetit të Evropës Juglindore (UEJL). Rektori i UP-



së, Prof. Dr. Marjan Dema dhe homologu i tij nga UEJL, Prof. Dr. Zamir Dika, nënvizuan se kjo marrëveshje e thellon edhe mëtej bashkëpunimin midis këtyre dy institucioneve të arsimit të lartë në fushën akademike dhe atë të kërkimit shkencor, në shkëmbimin e stafit dhe studentëve.

Ndihma e Shpejtë mezi arrin në vendngjarje

Tetovë, 15 shkurt - Automjetet e ndihmës së shpejtë janë duke u përballur me një dukuri të pazakonshme. Vetura të parkuara si brenda poashtu edhe jashtë hapësirave të Spitalit Klinik të Tetovës. Në rast urgjente, këto automjete nuk mund të arrijnë në kohë në vendngjarje si pasojë e kaosit që krijohet me veturat e parkuara në rrugën "29 nëntori" dhe përballë objektit ku janë të stacionuara automjetet e Ndihmës së Shpejtë. Vizitësit e automjeteve të ndihmës së shpejtë potencojnë se për të dalë dhe për të hyrë në hapësirat e Spitalit Klinik të Tetovës, është shumë vështirë, sepse veturat kanë zënë rrugën në të cilët duhet të qarkullojnë ata. Drejtori i Repartit të Ndihmës së Shpejtë, Afrim Aliu, thekson nevojën e hapjes së një hyrje të re për automjetet e ndihmës së shpejtë për të shmangur këtë kaos. "Automjetet e Ndihmës së Shpejtë shpeshherë hasin në vështirësi për tu përgjigjur në thirrjet urgjente që vijnë nga terren apo gjatë kthimit nga veturat e parkuara si jashtë, po ashtu edhe brenda. Ne si zgjidhje kërkojmë të hapet një hyrje e re enkas për automjetet e Ndihmës së Shpejtë që të jemi sa më efikas", tha Aliu. Në ndërkohë, problemi krijohet në hyrjen kryesore të Spitalit Klinik të Tetovës, ku edhe veturat edhe automjetet e Ndihmës së Shpejtë shfrytëzojnë këtë hyrje që shpeshherë krijon kaos në këtë vend. Nga ana e policisë rrugore pranojnë se në këtë pjesë të qytetit ka shumë automjete, ndërsa pika pagesore mund të pranojë vetëm një veturë që krijon pritje në radhë dhe praktikisht e rëndon komunikacionin në rrugën 29 nëntori. "Mundohemi të intervenojmë aq sa mundemi që të largojmë veturat që janë jashtë në rrugë përmes merimangës. Është shumë e stërnrgarkuar, por kjo vjen si pasojë e pikës së pagesës ku aty krijohet e tërë situata, dhe derisa të merret bileta dhe të mundësohet që vizitësi të hyjë brenda, jashtë krijohet tollovi", thotë Besir Qamili, zëvendëskryeshëf i Stacionit për Siguri në komunikacionin rrugor në Tetovë. (U.H)

SEKTORI PRIVAT NË MAQEDONI KËRKON HAPËSIRË



SHTETI,

JO PUNËDHËNËSI KRYESOR

Shteti duhet të heqë dorë nga ndikimi në rrjedhat ekonomike të shtetit, përmes realizimit të investimeve të ndryshme kapitale, duke u bërë kështu, punëdhënësi më i madh, në vend se këtë rol ta merr gradualisht sektori privat

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 15 shkurt - Shtyllat kryesore të rritjes ekonomike në vitet e kaluara ishin stimulimet fiskale përmes realizimit të projekteve të ndryshme infrastrukturore, eksportit të nxitur nga kompanitë në zonat e lira ekonomike si dhe konsumit të popullatës. Gjithashtu ekonomia e Maqedonisë, me afër 300 mijë pensionistë që për çdo muaj presin pensione nga shteti, me rreth 180 mijë të punësuar që presin rrogë prej buxhetit, me mijëra firma që presin punë nga tenderë publike të vlefshëm me qindra miliona euro tregon vartësi të madhe prej shtetit.

Ekonomistët thonë se në mënyrë graduale në vitet e ardhshme duhet të bie ndikimi i madh shtetit në rrjedhat ekonomike, sidomos është e papranueshme që shteti paraqitet si punëdhënësi apo edhe kontraktori më i madh i sektorit privat, përmes realizimit të investimeve të ndryshme kapitale, sepse vetëm në këtë mënyrë i lihet hapësirë dhe mundësi sektorit privat

të jetë lokomotiva e zhvillimit ekonomik të vendit. Vlerësohet se kompanitë vendore e kanë patjetër që të rrisin eksportin si në prodhime ashtu edhe në shërbime në degë të ndryshme si teknologjia informatike, bujqësia, blegtoria, apo turizmi.

Njëherësh duhet ndryshuar edhe struktura e pavolitshme e eksportit ku pak shesim jashtë prodhime me vlerë të shtuar, ndërkohë që vite me radhë eksportojmë lëndë të parë apo gjysmë prodhime. Vetëm në vitin 2016, katalizatorët e Xhonsion Meti, pjesët për ndezjen e veturës dhe të ngjashme, feronikeli dhe veshmbathja ishin asetet kryesore eksportuese të Maqedonisë. Nga ana tjetër, përkundër faktit se shquhemi si vend bujqësor, akoma kemi shkallë shumë të ulët të përpunimit të pemë perimeve, ku për shembull eksportojmë molla, ndërsa importojmë lëng molle. Sipas profesorit universitar Nasir Selimi, nuk ekziston një formulë magjike që sektori privat të zëvendësojë shtetin në zhvillimin ekonomik, megjithatë sipas tij hapi i parë në këtë drejtim është orientimi sa më i madh i kompanive vendore në gjetjen e tregjeve të reja.

"Sektori privat duhet të jetë më aktiv dhe këmbëngulës që të gjejë blerës të ri të prodhimeve dhe shërbimeve të tij si në tregun vendor ashtu edhe atë të jashtëm. Perspektiva, por edhe qëndrueshmëria e ekonomisë vendore qëndron vetëm tek rritja e të ardhurave nga eksporti për çka flet edhe fakti se të gjithë firmat e shohin ardhmërinë e tyre në këtë drejtim. Andaj nevojitet që edhe shteti me instrumente të ndryshme të ndihmojë biznesin, duke krijuar kushte dhe



TAKI FITI

Në një ekonomi tregu, udhëheqës kryesor i rritjes ekonomike dhe zhvillimit janë bizneset, ndërsa Qeveria nuk duhet të jetë investitori dhe punëdhënësi më i madh



TAKI FITI

Perspektiva, por edhe qëndrueshmëria e ekonomisë vendore qëndron vetëm tek rritja e të ardhurave nga eksporti për çka flet edhe fakti se të gjithë firmat e shohin ardhmërinë e tyre në këtë drejtim

lehtësime për kompanitë vendore eksportuese", thekson më tej Selimi.

Sipas tij, nevojitet që të ofrohet një mbështetje më e madhe në formë të trajnimeve, promovimeve të prodhimeve vendore, vendosjes së kontakteve përmes përfaqësive diplomatike me qëllim që kompanitë të zgjerojnë kapacitetet e tyre prodhuese dhe të rrisin prezencën në tregjet e jashtme. Në ndërkohë edhe njohësit e tjerë të ekonomisë vlerësojnë se shteti nuk duhet të jetë punëdhënësi dhe kontraktuesi më i madh në shtet përmes investimeve të ndryshme duke pasur në disponim për të harxhuar afër 3.5 miliardë euro në vitin 2018.

"Sivjet do të kemi buxhetin më të madh në historinë e shtetit që në mënyrë indirekte tregon se ekziston përzierje e madhe e shtetit në ekonomi. Në një ekonomi tregu, udhëheqës kryesor i rritjes ekonomike dhe zhvillimit janë bizneset, ndërsa Qeveria nuk duhet të jetë investitori dhe punëdhënësi më i madh", thotë akademiku Taki Fiti. Sipas tij, duhet të ekzistojë përzierja e shtetit por me një kufi të caktuar, ndërsa roli i shtetit duhet të jetë krijimi i një ambienti të favorshëm për biznes që të mundën kompanitë të nxitin të investojnë. Ndryshe, në vitet e ardhshme sfidat kryesore sipas Bankës Botërore për të gjitha shtetet e rajonit dhe jo vetëm për Maqedoninë, janë ndryshimi i rolit të shtetit në ekonomi, nga roli i mbështetësit në rolin e atij që mundëson rritje ekonomike, lirinë e potencialit të kompanive private, përmirësimin e tregut të punës dhe kapitalit njerëzor si dhe integrimin në BE dhe ekonominë globale.

217 ankesa për punën e Gjykatësve

Shkup, 15 shkurt - Mbi 200 parashtrës dhe ankesa kanë aritur deri te Këshilli Gjyqësor i Maqedonisë. Kryetari i këtij Këshilli, Zoran Karaxhovski, të enjten, pas përfundimit të pjesës së parë të seancës së Këshillit, tha se në opinion është lëshuar një lajm i rremë, se gjoja Këshilli do të shkarkojë rreth 100 gjykatës. Në fjalimin para gazetarëve, ai theksoi se brenda këtyre ditëve atij i janë lajmëruar një numër rekord i gjykatave, duke kërkuar sqarim se a është e vërtet se do të bëhet shkarkimi i një numri kaq të madh të gjykatësve. Mirëpo, ai bëri të ditur se opinioni dhe mediat duhet të bëjnë dallimin mes ankesave (parashtrësve) dhe kërkesave për shkarkim të gjykatave. "Deri në këto momente, në Këshill janë dorëzuar saktë 217 ankesa dhe parashtrës të iniciuara nga persona fizik dhe persona juridik. Reagimet e tyre janë lidhur me punën e gjykatave dhe kryetarëve të gjykatave", tha Karaxhovski. Ndryshe, kryetari i Këshilli Gjyqësor foli edhe për raportin e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me sistemin e shumëpërfolur të keqpërdorimit "AKMIS". Ai, me këtë rast u shpreh se janë në fazë të pranimit të certifikatave për siguri. Vetëm gjashtë anëtarë të Këshilli Gjyqësor për momentin posedojnë këto lloje të certifikatave për të realizuar kontroll mbi këtë raport të ministrisë. Megjithatë, siç tha ai, nuk ka njohuri se pse ky raport është me karakter të besueshëm. Sidoqoftë, ai nuk e komentoi procedurën parahetimorë që Prokuroria Publike e ka filluar për raportin e grupit punues të Ministrisë së Drejtësisë për sistemin "AKMIS". (O.Xh)

Për një javë, 2964 të sëmurë nga gripi

Shkup, 15 shkurt - Gjatë javës së fundit (nga 5 shkurti deri më 11 shkurt) në Maqedoni janë regjistruar 2964 të sëmurë nga gripi, që është rritje për 48 për qind në krahasim me javën para saj kur ishin regjistruar 2001 persona të sëmurë, theksohet në raportin që në ueb faqen e tij sot e publikoi Instituti për shëndet publik. Në

lidhje me sezonin e fundit kur u regjistruan 386 të sëmurë, ekziston rritje të numrit për 7.7 herë të numrit të të sëmurëve në javën e gjashtë të vitit. Numri më i madh i të sëmurëve - 1650 janë paraqitur në grupin më të madh të moshës prej 15-64 vjeç, ndërsa te fëmijët e moshës 5-14 vjeç ka 327 raste në 100.000 banorë. Këtë javë numri

më i madh i personave të sëmurë - 326 janë paraqitur nga rajoni i Njësisë rajonale Gostivar, ndërsa incidenca më e lartë 576,5 në 100.000 banorë është regjistruar në rajonin e Njësisë rajonale Dibër. Nga gjithsej 31 njësi raportuese në vend, vetëm në rajonin e NJR Dibër, Kratovë, Resnje, Kavadar dhe Makedonski Brod regji-

strohet aktivitet shumë i lartë. Në rajonin e Qendrës për shëndet publik Manastir dhe NJR Kërçovë është regjistruar aktivitet i lartë, në rajonin e shtatë qendrave për shëndet publik/njësitet rajonale-aktivitet të mesëm, në rajonin e nëntë qendrave për shëndet publik/njësite rajonale-aktivitet të ulët, në nëntë njësite rajonale

regjistrohet aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit, ndërsa gjashtë njësitet tjera rajonale këtë javë nuk kanë paraqitur të sëmurë nga gripi/ sëmundje të ngjashme me gripin. Deri më tani në sezonin 2017/2018, numri i përgjithshëm i rasteve të paraqitura me të sëmurë të ngjashëm të gripit arrin 8443.

NDËRMJETËSIMI PËR PUNË JASHTË SHTETIT

LIGJI QË DO TË PARANDALOJË MASHTRIMET

Nuk ka muaj që nuk raportohet për zhgënjime të studentëve, por edhe të tjerëve lidhur me mashtrimet për punë me letra të rregullta në shtetet Perëndimore. Qeveria siguron se me ligjin e ri, që aktualisht është në fazë përgatitore, do sanksionohen rëndë mashtrimet

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 15 shkurt - Me shpresë se për tre muaj punë në Gjermani do të fitojë më shumë të holla se për një vjet në Maqedoni, më shumë qytetarë drejtohen të punojnë për disa muaj jashtë shtetit. Punëtorët që kanë fatin të gjejnë një punë sezonale, duke shfrytëzuar edhe njohjet private, që në fund ju paguhet, edhe mund të jenë lumtur, përkundër kompensimit eventual për ndërmjetësimin në punë. Ekzistojnë raste kur ëndrrat për një punë të paguar bëhen realitet, por jo rrallë ndodhin edhe raste të mashtrimeve përmes premtimeve për kontrata pune jashtë vendit, ku qindra qytetarë gënjehen nga agjencitë që përfitojnë shuma të majme parash nga qytetarët për shërbimet e rrejshme të tyre. Që të parandalohen këto dukuri rekomandohet që qytetarët të bëjnë më shumë kujdes kur bëhet fjalë për punësimin jashtë shtetit duke mbajtur llogari se çka nënshkruajnë.

Njohësit e kësaj problematike, por edhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale thonë se qytetarët duhet menjëherë të paraqesin të gjitha parregullsitë si në Ministrinë e Brendshme ashtu edhe në Inspektoratin e punës, ndërsa presin që ligji i ri që rregullon këtë problematikë, i cili së shpejti duhet të kalojë filtrat qeveritar dhe parlamentar, do të vendos më në fund rend lidhur me ndërmjetësimin për punë jashtë shtetit.

MASHTRIMET E DETEKUARA

Në ndërkohë, gati që nuk ka muaj që nuk raportohet në Maqedoni për zhgënjim të radhës të studentëve, por edhe të tjerëve lidhur me mashtrimet për punë me letra të rregullta në shtetet Perëndimore. Në verën e vitit të kaluar, sipas raportimit të televizionit lokal në Shtip "TV IRIS", nga një agjenci për ndërmjetësim me seli në këtë qytet, janë mashtruar qindra studentë për punë në Gjermani. Studentëve nga Strumica, Kumanova, Velesi dhe Shtipi në intervistat për punë iu është kontrolluar niveli i njohurisë për gjuhë të huaj, për çka kanë paguar në dorë nga 2000 denarë. Pastaj disa nga studentët për kompensimin e ndërmjetësimin



kanë paguar nga 500 euro, ndërsa të tjerët nga 250 euro, por në fund - intervistat e parashikuara me punëdhënësit as që janë mbajtur ndonjëherë. Mashtrimi me punën e premtuar në Gjermani është detektuar në datën 15 qershor kur grupi i parë i studentëve është dashur të fillojnë punën në brendin e njohur Zara, megjithatë studentët nuk kanë fituar lejet e premtuara të punës. Nga ana e Inspektoratit të punës është sjellë vendim për ndalesën e punës së agjencisë për punësim brenda dhe jashtë shtetit në kohëzgjatje prej një muaji dhe kërkesë për procedurë për kundërvajtje.

Në 19 janar të këtij viti, I.M. ka denoncuar në polici se është mashtruar për 80 mijë denarë në lidhjen me gjoja punësimin në Gjermani. Sipas MPB-së, I.M. për punën në këtë shtet ka kontaktuar me D.K. pas publikimit paraprak në "Reklama 5". D.K. i ka thënë atij se menjëherë duhet të fillohet me procedurën për pagesën e mjeteve për përkthimin e formularëve nga gjuha maqedonase në gjuhën gjermane, ndërsa pagesa duhet të realizohet menjëherë në llogarinë bankare. Kompetentët po ndërmarrin masa për zbardhjen e tërësishme të rastit.

Lidhur me mbrojtjen e qytetarët të shkaktoara nga mashtrimet eventuale nga ana e disa kompanive jo të përgjegjshme që ndërmjetësojnë për punë jashtë shtetit, për gazetën KOHA, nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale thonë se të gjitha shoqëritë tregtare që ndërmjetësojnë për punë jashtë shtetit, nevojitet që punën e tyre ta harmonizojnë në përputhje me ligjin. Punën e tyre, apo zbatimin e ligjit, e kryen organi shtetëror i autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese ose Inspektorati Shtetëror i Punës ku paraqiten të gjitha



Studentë nga Strumica, Kumanova, Velesi dhe Shtipi në intervistat për punë iu është kontrolluar niveli i njohurisë për gjuhë të huaj, për çka kanë paguar në dorë nga 2000 denarë. Pastaj disa nga studentët për kompensimin e ndërmjetësimin kanë paguar nga 500 euro, ndërsa të tjerët nga 250 euro, por në fund - intervistat e parashikuara me punëdhënësit as që janë mbajtur ndonjëherë

shkeljet e ligjit.

Lidhur me faktin se si kontrollohet puna e këtyre kompanive dhe marrjes së lejeve për punë të tyre nga kjo ministri thonë se kjo

çështje është e rregulluar me ligj.

"Me ligj përcaktohet se në çilat raste mund t'ju merret licenca shoqërive tregtare të regjistruara si agjenci për ndërmjetësim gjatë punësimit jashtë shtetit. Me marrjen e licencës, agjencia ndërpret me kryerjen e veprimtarisë për ndërmjetësim të punësimit. Marrja e licencës të shoqërive tregtare për kryerjen e ndërmjetësimin për punë jashtë shtetit mund ta kryhet vetëm kur Inspektorati i Punës do të konstatojë parregullsi në punë, pas kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, në rast se nuk zbatohet ose zbatohet në mënyrë të parregullt ligji që rregullon punën e tyre si dhe kur janë plotësuar kushtet për marrjen e licencës. Nga evidenca e regjistrave që udhëhiqen për këtë lloj agjencish për ndërmjetësim për punë jashtë shtetit deri tani janë fshirë tri agjenci në bazë të punës jo të rregullt", bëjnë të ditur për gazetën KOHA nga ky dikaster.

ÇKA PARASHOHIN NDRYSHIMET LIGJORE?

Pritet që ndryshimet ligjore që rregullojnë procedurat e punës jashtë shtetit, të vendosin një rend



NORIK SELIMI

Ndodh që agjenci të ndryshme turistike të dërgojnë vajza për pushime jashtë shtetit, ndërsa në praktikë i dërgojnë të punë në të zeze përgjatë sezonit turistik në vendet fqinje. Me ndryshimet e reja ligjore, atyre askush nuk ua ndalon të fitojnë licencën edhe për ndërmjetësim të punës brenda dhe jashtë shtetit, por duke respektuar të gjitha obligimet ndaj shtetit dhe klientit që kërkohen me ndryshimet e reja ligjore

më të madh në punën e agjencive për ndërmjetësim për punë jashtë shtetit, me qëllim të minimizimit të mashtrimeve të ndryshme, por edhe për të mbrojtur në maksimum qytetarët e Maqedonisë që janë të interesuar të punojnë përkohshme jashtë shtetit me dokumente të rregullta.

"Në rrjedhë e sipër është edhe miratimi i Ligjit të ri për agjencitë private për punësim. Me këtë ligj tërësisht do të përcaktohet mënyra e licencimit, kushtet për kryerjen e veprimtarisë për të cilën ato janë licencuar si dhe kushtet për humbjen e licencës për kryerjen e veprimtarisë. Me këtë ligj përfshihet puna e agjencive për punësime të përkohshme, për ndërmjetësim për punësim në vend, për ndërmjetësim për punë jashtë shtetit dhe për punësim në vend dhe jashtë shtetit.", thonë nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Në ndërkohë njohësit e kësaj problematike thonë se mungesa e një rregullative më të qartë ligjore për punën e agjencive të

MPB: KATËR PADI PËR PUNË TË RREJSHME

Nga Sektori i Punës së Brendshme në Shkup për gazetën KOHA thonë se në kuadër të autorizimeve dhe kompetencave të tyre, kanë ndërmarrë masa dhe aktivitete lidhur me veprat penale "mashtrim", me ç'rast gjatë vitit 2017 dhe në janar të këtij viti janë evidentuar gjithsej 109 vepra penale, për çka janë denoncuar 66 persona. Nga numri i përgjithshëm i veprave penale "mashtrim", janë evidentuar katër vepra penale të realizuara nga katër persona dhe një vepër penale "ndihmë gjatë kryerjes së mashtrimit", e realizuar nga dy persona, kryerësit e së cilës kanë pasur qëllim të përfitojnë në aspekt material në mënyrë të kundërligjshme, ndërsa me tregimin e fakteve të



rrejshme kanë sjellë në huti shtatë persona se: do t'ju mundësojnë punësim sezonal në Mal të Zi; do t'ju mundësojnë punësim si shofer për nevojat e NATO-s në Maqedoni; do t'ju mundësojnë punësim në ambasadën e SHBA-ve në Maqedoni si asistent në projekt; do t'ju mundësojnë punësim jashtë shtetit (pa theksuar destinacionin-shtetin)... Lidhur me veprat e kryera penale, MPB në kompetencë të Prokurorisë Themelore Publike në Shkup ka dorëzuar katër kallëzime penale sipas nenit 247 të Kodit Penal, ku janë theksuar lartësitë e dënimeve në varësi prej dëmit të kryer dhe të njëjtat i përcakton gjykata kompetente, në procedurën e mëtejshme penale nëse e njëjta realizohet.

ndërmjetësimit për punë jashtë shtetit, si dhe mungesa e një kontrolli më të madh të shpalljeve për punë jashtë shtetit shkaktonte huti të madhe në opinion, si dhe prodhon edhe keqpërdorime gjatë punës jashtë shtetit.

"Presim që Ligji i ri për punën e agjencive që ndërmjetësojnë për punë jashtë shtetit të vendosë rregulla më të qarta të lojës për të gjithë, si për qytetarët ashtu edhe për bizneset. Aktualisht shumë gjëra nuk janë të qartësuar sa duhet si në sistemin e ndjekjes së punës, kontrolleve dhe dënimeve më të rrepta e kështu me radhë. Njëherazi edhe pasi të miratohen ndryshimet ligjore duhet pasur kujdes me zbatimin e tyre në praktikë, për shkak se tek ne kemi ligje shumë të mira por ngacshpesh zbatimin e tyre në praktikë", thotë Norik Selimi, kryetar i Shoqatës Kombëtare të Agjencive për Punësim të Përkohshme. Sipas tij, ndryshimet e reja ligjore pritet të vendosin një rend më të madh në këtë fushë.

"Ndodh që agjenci të ndryshme turistike të dërgojnë vajza për pushime jashtë shtetit, ndërsa në praktikë i dërgojnë të punë në të zeze përgjatë sezonit turistik në vendet fqinje. Me ndryshimet e reja ligjore, atyre askush nuk ua ndalon të fitojnë licencën edhe për ndërmjetësim të punës brenda dhe jashtë shtetit, por duke respektuar të gjitha obligimet ndaj shtetit dhe klientit që kërkohen me ndryshimet e reja ligjore", shton më tej Selimi.

Në ndërkohë, raste të mashtrimeve me punë, sidomos në Gjermani, kanë ekzistuar edhe më herët, por janë shfaqur me efekte dhe lloje të ndryshme. Kriza e madhe ekonomike si dhe papunësia e lartë në rajon në vitet e fundit vetëm kanë lehtësuar punën e mashtruesve duke rritur numrin e viktimave potencial si dhe skemave të mashtrimit. Andaj sugjerohet që kur kërkoni punë të zgjidhni me kujdes ndërmjetësin për punë jashtë shtetit.

Raste të tilla të mashtrimit për punë të përkohshme në shtetet perëndimore nuk mungojnë në asnjë nga shtetet e rajonit. Në Shqipëri në vitin e kaluar ndër të tjerash u denoncua rasti i një agjencie që përdorte një skemë të ngjashme me firmat piramidale: me premtimin për kontrata pune jashtë vendit, qindra shqiptarë janë gënjyer nga agjencia e cila ka përfituar shumën e majme parash përgjatë viteve. Në muajin gusht të vitit të kaluar, edhe Policia e Kosovës ka bërë të ditur se ka arrestuar një person me akuzën e mashtrimit të vizave të punës në Gjermani.

Edhe në shtetet e tjera të rajonit si Bosnje e Hercegovina, Kroacia, Serbia apo Mal të Zi gati për çdo muaj raportohet për mashtrimet e përkohshme të qytetarëve jashtë shteteve të rajonit.

KRYETARI I SHGM-SË, NASER SELMANI

REFORMA NË RTVM TË MOS PËRFUNDOJË ME PAZARE

"Duket se presioni i partive ishte i madh. Patëm kontakte me anëtarët e Këshillit programues, ka disponim për t'u biseduar, megjithatë, kur u përzien partitë, atëherë njerëzit u tërhoqën", tha Selmani

Shkup, 15 shkurt - Kryetari i Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë, Naser Selmani pas zgjedhjes së drejtorëve të servisit publik radiodifuziv, deklaroi se druan që reforma në RTVM do të përfundojë në pazare dhe marrëveshje ndërpartiake. "Sa i përket çështjes për zgjedhjen e drejtorit të vjetër të ri të TVM-së me të vërtetë më vjen keq që u lëshua një mundësi e artë, e papërsëritshme, do të thosha, të tregojmë se ne si shoqëri kemi kapacitet të përballimi me sfidat. Duket se presioni i partive ishte i madh. Patëm kontakte me anëtarët e Këshillit programues, ka disponim për t'u biseduar, megjithatë, kur u përzien partitë, atëherë njerëzit u tërhoqën", tha Selmani. Sipas tij, po tregohet se njerëzit në Maqedoni më shumë tregojnë lojalitet ndaj partisë së cilës i takojnë se sa interesit publik dhe interesit të qytetarëve. "Ajo që mua më së shumti më shqetëson është që nuk shoh masë kritike në establishmentin politik, qofshin ata nga pushteti



apo nga opozita, t'i kuptojnë seriozisht reformat mediale. Unë drua se nga reformat mediale, reforma në RTVM do të përfundojë në pazare dhe marrëveshje ndërpartiake", tha Selmani. SHGM, shtoi ai, do ta ndjekë procesin dhe menjëherë do të reagojë, çdoherë kur do të konsiderojë se ato zgjidhje nuk janë në pajtim me standardet evropiane dhe interesat e qytetarëve. "Ne fuqimisht bëjmë presion që servisi publik të pavarësohet, të lirohet nga kontrolli politik, ndërkaq nga ana tjetër kërkojmë edhe gjithësi konstruksion të qëndrueshëm financiar i cili do t'i mundësojë servisit publik t'i përmbushë obligi-

met", tha Selmani, pas nënshkrimit të Memorandumit për bashkëpunim me Komisionin për qasje të lirë drejt informatave të karakterit publik. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, tha Selmani, do të mbështesë një pjesë të këtyre propozimeve të Komisionit për ndryshimin e Ligjit për qasje të lirë drejt informatave të karakterit publik. "SHGM-ja i mori vërejtjet dhe seriozisht mendojmë pjesën më të madhe të tyre t'i mbështesim dhe të qëndrojmë pas tyre sepse janë vërtetë vërejtje të argumentuara të cilat mendojmë se do ta përmirësojnë Ligjin", tha Selmani, i cili gjithashtu, nga Kuvendi kërkoi që

sa më shpejtë t'i plotësojë vendet e zbrazëta në Komision, që ai të punojë në përbërje të plotë.

Me Memorandumin për bashkëpunim mes Komisionit dhe SHGM-së janë paraparë, në përgjithësi aktivitete për ngritjen e vetëdijes publike te qytetarët për të drejtën e qasjes deri te informacionet me karakter publik. Për këtë qëllim do të organizohen trajnime dhe fushata të cilat do të kontribuojnë që institucionet të bëhen më transparente për gazetarët dhe për qytetarët si shfrytëzues të së drejtës të garantuar kushtetuese të qasjes së lirë deri te informacionet me karakter publik. (O.XH)

Midis Tetovës ankesa për diskriminim etnik!

Tetovë, 15 shkurt - Përmes një letre anonime, disa të punësuar në Agjencinë për Punësim në Tetovë kanë drejtuar akuza ndaj ish-udhëheqësve dhe udhëheqësve aktual të këtij institucioni. Në letër ata thonë se ish-drejtorët dhe drejtorët aktual shlyejnë nga evidenca vetëm të regjistruar shqiptarë pa të drejtë ankimi. Sipas kësaj letre anonime, masat aktive për punësimin e të rinjve deri në 29 vjet i kanë shfrytëzuar 90 kandidatë maqedonas. Po ashtu, sipas tyre, edhe disa masa tjera siç janë kreditimi për punësim, puna praktike, kurse të gjuhëve të huaja... favorizohen vetëm kandidatët maqedonas, leja e vozitjes për kategorinë C për të cilin agjencia ndanë mjete, i kanë shfrytëzuar 100 për qind qytetarët maqedonas. Sipas kësaj letre anonime, nga periudha 2007 deri në 2012, drejtuesit e këtij institucioni kanë

shlyer 2100 të evidentuar shqiptarë. Administratorët ankohen se edhe janë të diskriminuar edhe në ndarjen e posteve udhëheqëse. Por nga ana e drejtorit të këtij Agjencie, Ljupço Apostollovski, janë mohuar kategorikisht akuzat duke nënvizuar se në këtë agjenci nuk ka diskriminim në baza etnike. "Në lidhje me këtë shkresë, unë moralisht dhe me përgjegjësi më të madhe them se janë të pabaza. Të gjitha palët që vijnë këtu marrin shërbime pa dallim të përkatësisë etnike së tyre. Asnjë palë që është dashur të marrë shërbime, nuk ka ankësuar për mos marrje të shërbime. Nuk ekziston asgjë që mund të bëjmë ndarje në baza etnike", tha Apostollovski. Ai më tej shpreh se ka rregulla të reja për ardhjen në kohë në punë dhe këto rregulla duhet të respektohen nga të gjithë që qytetarët të marrin shërbime sa më të mira. (U.H)

VMRO: Zero investime dhe vende të hapura pune

Shkup, 15 shkurt - Zero investime të huaja të reja dhe zero vende të reja të hapura, thuhet në reagimin me shkrim nga VMRO-DPMNE ndaj konferencës për shtyp të zëvendëskryeministrit për Çështje Ekonomike, Koço Angjushhev dhe ministrit të Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi. "Ky është bilanci nga politikat katastrofale ekonomike të qeverisjes destruktive dhe shkatërruese të ekipit të paafte ekonomik të LSDM-së. Gjithçka tjetër është gënjeshter dhe lavdërim me rezultatet e arritura në kohën e qeverisë paraprake të VMRO-DPMNE-së. Përveç fjalëve të zbrazëta, në konferencën e sotme për shtyp të Angjushhevit dhe Bekteshit publikisht nuk dëgjojmë se ka filluar me punë madje edhe një kompani të cilën ata e kanë sjellë të investojë në Republikën e Maqedonisë", thuhet në reagimin e

VMRO-DPMNE-së. Në reagim shtohet se përkundrazi LSDM-ja vazhdon që projektet e VMRO-DPMNE-së t'i paraqesin si projekte të tyre. Nga ajo që prezantuan si investim të ri, thuhet më tej, argumentet thonë se katër kompani tanimë janë të pranishme në Maqedoni dhe një vit të plotë prisnin marrëveshje, ndërsa Qeveria e paafte pas një viti u ndau ndihmë shtetërore. "Kompania 'Kostal' është kapacitet tanimë ekzistues i cili punon dhe eksporton nga fabrikat e saj në Ohër. Kompania 'Murat vajaring sistem', 'Çagataj' dhe 'VIK' janë kompani të cilat vendimet e tyre për investim i sollën në kohën e qeverisë së VMRO-DPMNE-së dhe kanë filluar proces ndërtimi në kapacitete personale. Këto kompani më shumë s'është vit prisnin marrëveshje", thuhet në reagimin e VMRO-DPMNE-së

Maqedonia në mes të Greqisë dhe Turqisë



Nga
Selim IBRAIMI

Ministrat e Jashtëm të Maqedonisë dhe të Greqisë i kanë filluar bisedimet dy palëshe duke i dhënë procesit të negociatave një pamje më reale, ndërkohë që ditë më parë kryeministri Zoran Zaev u takua me presidentin dhe kryeministrin e Turqisë Rezhep Taip Erdogan dhe Binali Yildirim.

Vizita e kryeministrit Zoran Zaev u realizua në një kohë kur Shkupi ka hyrë në negociata me palën greke rreth ndryshimeve të emrit, ndërkohë Greqia mundohet të tregohet se është më e fortë në procesin negociues dhe më kooperative për bashkësinë ndërkombëtare.

Në fakt kryeministri Zaev me takimin e tij me Erdoganin e ka përforcuar pozitën e tij dhe të qeverisë kundrejt Athinës.

Një aleancë strategjike në mes Maqedonisë dhe Turqisë është më se e nevojshme për Maqedoninë dhe i përgjigjet situatës aktuale ku është duke notuar qeveria e re në kontekst të zgjidhjes së emrit.

Maqedonia dhe Turqia kanë vendosur marrëdhënie diplomatike që nga gushti i vitit 1992 dhe kjo për Maqedoninë ka qenë një ndihmë për të mbajtur gjallë vendin pas shpërbërjes nga Beogradi dhe bllokadës që vinte atëherë nga Greqia.

Se një Aleancë është në ngritje dhe me prioritet flet vetë deklarata e kryeministrit turk.

Kryeministri i Turqisë ka deklaruar se është e gabuar që Greqia të diktojë se çfarë emri zyrtar duhet të mbajë Maqedonia, por ka thënë se shpreson se dy vendet fqinjë mund ti zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre në mënyrë miqësore.

Duke folur në një konferencë shtypi me kryeministrin Zoran Zaev të hënën, Binali Yildirim tha: "Është e gabuar që një vend tjetër të përcaktojë emrin e një vendi".

Dy ditë pas protestave në Greqi, kryeministri Zoran Zaev deklaroi se vendi i tij ishte i gatshëm të bëjë kompromis, duke sugjeruar opsione të ndryshme si përdorimi i "përcaktimeve gjeografike", pra riemërimi i vendit si "Maqedonia e Epërme", "Maqedonia Veriore" ose "Maqedonia e Re".

Greqia në një farë forme ka frikë se vazhdimi i 'status quos' do të mund të dobësojë vetë Greqinë në rajon dhe në raport më rivalin e saj Turqinë.

Marrëdhëniet jo të mira fqinjësore midis Athinës dhe Shkupit

ndikojnë që Turqia të rrisë ndikimin e saj në Ballkanin Perëndimor si pjesë e një politike që ka qëllime të qarta dhe të caktuara gjeostrategjike.

Erdogani dhe qeveria turke asnjëherë nuk e ka kundërshtuar pranimin e Maqedonisë në NATO dhe ka akuzuar vazhdimisht Greqinë se ka vepruar padrejtësisht që nga viti 1991 në parandalimin e Shkupit për tu bërë pjesë e Aleancës.

Turqia tashmë për më shumë se një dekadë ka një ndikim të theksuar në Ballkan dhe është në fazën e shtrirjes së influencës.

Sipas raporteve të Qendrës së Studimeve Strategjike me bazë në Stamboll, më 17 mars 1994 në mes Maqedonisë dhe Turqisë u nënshkrua Marrëveshja e Tregtisë dhe Bashkëpunimit Ekonomik. Marrëveshja për Parandalimin e Tatimit të Dyfishtë u nënshkrua më 16 qershor 1995 dhe Marrëveshja për Mbrojtjen dhe Promovimin e Ndërsjellë të Investimeve u nënshkrua më 14 korrik 1995. Për më tepër, Marrëveshja e Tregtisë së Lirë u nënshkrua më 7 shtator 1999.

Si fillim i marrëdhënieve ushtarake mes dy vendeve, një Protokoll i Sigurisë u nënshkrua në Ankara më 18 maj 1992. Marrëdhëniet ushtarake

janë përqëndruar kryesisht në asistencën e stërvitjes ushtarake dhe në grantet e dhëna për mbështetjen logjistike të ushtrisë maqedonase. Asistenca ushtarake e trajnimit kryhet në përputhje me Marrëveshjen e Bashkëpunimit të Trajnimit Ushtarak e nënshkruar në vitin 1994. Gjithashtu, një Marrëveshje për Bashkëpunim në Industrisë e Mbrojtjes u nënshkrua në mes të dy vendeve në prill të vitit 1995.

Për më tepër, sipas Dhomës Tregtare të Maqedonisë, shkëmbimi i përgjithshëm tregtar i Republikës së Maqedonisë me Republikën e Turqisë në 9 muajt e parë të vitit 2017 ishte 314,9 milion US \$, që është një rritje prej 4,1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Vlera e eksportit është 60,1 milion US \$ për 9 muajt të 2017, ndërsa bilanci i importit ishte 254,8 milion US \$.

Republika e Turqisë është partneri i tetë tregtar në shkëmbimin e tregtisë së jashtme të Maqedonisë për 9 muajt e parë të vitit 2017.

Për më shumë përderisa Turqia është duke vazhduar me politikën e zgjerimit, Greqia pa forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me shtetet e Ballkanit në shumë nivele do ta ketë

Marrëdhëniet jo të mira fqinjësore midis Athinës dhe Shkupit ndikojnë që Turqia të rrisë ndikimin e saj në Ballkanin Perëndimor si pjesë e një politike që ka qëllime të qarta dhe të caktuara gjeostrategjike. Përderisa Turqia është duke vazhduar me politikën e zgjerimit, Greqia pa forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me shtetet e Ballkanit në shumë nivele do ta ketë vështirë të jetë lider i Ballkanit Jugor ose të bëhet rivale e Turqisë.



vështirë të jetë lider i Ballkanit Jugor ose të bëhet rivale e Turqisë.

Pëkundër dallimeve rreth emrit, në marrëdhëniet tregtare në mes vendeve, Greqia është një nga partnerët më të mëdhenj tregtarë të Maqedonisë. Shëmbimi përgjithshëm në mes Maqedonisë dhe Greqisë për vitin 2016 ishte 598 milion Euro. Kompanitë greke kanë investuar në sistemin bankar, në industrinë e naftës, atë të tekstilit dhe në sektorët tjerë të rëndësishëm të ekonomisë së Maqedonisë. Në këtë drejtim përmirësimi i marrëdhënieve me Maqedoninë është në interesin kombëtar të Greqisë.

Aleancat ndërtohen në kohë të vështira dhe pa dyshim Maqedonia si pjesë e hapësirës post-otomane, luan rol të rëndësishëm në konfigurimet aktuale. Në fakt, koha kalon dhe shumica e shteteve anëtare të OKB-së, e kanë njohur vendin si "Republika e Maqedonisë" ndërsa vazhdimi i 'status quos' ka dëmtuar Athinën në disa fronte dhe duke e bërë Ballkanin Jugor pjesë të lojrave gjeopolitike jo vetëm në nivel rajonal por edhe në atë global.

Autori është themelues i Institutit të Studimeve të Sigurisë dhe Zhvillimit

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 15 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

10 vjet vetmi

Nga
Kimete Berisha



Te 'rrethi' ish dashur të valvitet çanta e Anita Haradinaj, se ajo çantë kushton 2000 euro më 'shtrenjtë' se flamuri kombëtar, që pak me pas durim m'u shty me shitësin n'aksham pasar ta lë në dorë me 2 euro.

Që thoshte, i shkreti, Dritëro Agolli, 'leckë është flamuri'. Çanta e Anitës e tregon standardin e Republikës së Kosovës, dhe aftësinë e gruas së Rambos se si me rrogën 600 euro (kurrë pa shku n'punë), mund ta blejë 'gospoxha' çantën 2,000 euro.

Thonë që ka thënë Zoti, se njerëzit e këqij jetojnë gjatë. Aq gjatë, sa një shekull. Prandaj, na mbyti mërzia... s'ka njeri normal që sot nuk e ndjen veten 'gotë e zbrazur' në këtë vend, të pushtuar nga llumi i shoqërisë, të udhëhequr nga niveli më i ultë i mundshëm që ekziston mbi këtë dhé.

Kurrë më keq dhe më e shpërfytyruar, më e dhunuar, më e shëmtuar, më e ndyrë, më e varfër se sa tani nuk ka qenë Kosova.

Si gotë e zbrazur ndjehem edhe unë sot e përditë ç'prej se Rambo dhe 120 hajdutat e tij i bën nderime me një minutë heshtje vrasësit të fëmijëve shqiptarë, Oliver Ivanoviqit...

Çka mund të bëj një njeri më keq se kjo që ka bërë Ramush Haradinaj!

Kur vjen puna deri këtu, sa ta kemi luksin të flasim për dashuri, si sot në 'ditën e të dashuruarve', duhet të tregojmë të vërtetën se sa shumë urrehemi o Zot.

S'dua të flas për dashurinë, mbase që ka ardh puna deri këtu sa sot nuk i njoh dy njerëz që kalon dita pa e lënduar dhe pa e fyer njëri-tjetrit, më së paku një herë në ditë, a po do me fjalë, a po do me vepra, a po do me heshtje, a po do me stupc.

Dashuria është armiku ynë më i madh. Sepse, nuk e lëmë të na pushtojë e të na bëj njerëz normal.

Ne ia plasim zemrën njëri-tjetrit, kurrë pa pushu. Këta jemi ne. Dhe nuk ngihemi derisa të sigurohemi se veç kacia ka mbetur pa e kryer punën e 'saj'.

Prandaj, më egër duhemi, sesa urrehemi.

E këtyllë, e cekët, e thjeshtë, injorante dhe e ndyrë sa s'ka ishte edhe korrespondenca intime në kuvendin shqiptar, në mes shtetases shqiptare GD dhe atij djalit me buzë të kuqe.

Të tilla janë sekretet, të ndyra dhe të turpshme, prandaj mbahen fshehtë.

Gratë e mira nuk kanë sekrete.

Gratë shqiptare, agresive siç janë, deri në atë shkallë sa në këtë korrespondencë seksuale nuk dihej cili ishte mashkull aty.

Shtetasja shqiptare assesi të bin-



dej se si ndodhi që ajo, heeej asaj i ndodhi, të shfrytëzohet dhe të braktiset nga një djalë 10 vjet më i ri.

Kot bundat, pelerinar e fustanat me kallana, s'bëjnë punë mëngët e qëndisura me detaje aq të shumta sa tavanet e katedraleve të Venedikut, e flokët strofull nga llaku i pakompromis TAFF që nuk e lë as ajrin të hyjë mes llokmave të saj të ngjira.

Të lë, për besë të lënë gjinja, mashkulli më i keq ta ftoh jetën, dhe besa ta shkatërron pjesën e mbetur të jetës, e cila të kalon duke kërkuar arsye tjera se pse të çoi përtej diellit një mashkull i keq, duke e pasur ti arsyen si zonjë para hundës, që është gjithmonë e njejta arsye pse të mashtrojnë dhe të tradhtojnë njerëzit, thjesht veç pse s'të duan.

Të gjitha luftërat i fitojnë vajzat e urta dhe të buta. Kurrë deri sot, asnjë grua e 'shtirë', e rrezikshme dhe arrogante, që flet shumë dhe me zë të lartë, nuk gjeti prehje, paqe e dashuri në këtë jetë.

Është normale të flasësh për jetën private të dikujt (kur bëhet publike), aq sa është normale të shikosh seriale, shtyrë nga kureshtja kush me kë e bën e kush me kë ndahet. Kjo është natyra jonë. Tema mbi të cilën u shkrua bota dhe jeta sillet rreth ushkurit. S'ke çka bën.

Boll e ka që nuk ia bëjnë si të 'E bija e Rajanit', me ngreh zhag prej zhelesh jashtë nga katundi.

Nuk kisha dashur të rilindesha përsëri, kurrë, por nëse s'do të pyetem, si kësaj here, do të zgjedhja ta dua vetëm veten, kurrë pa sakrifikuar as një qime të flokut për asgjë dhe për askënd. Të provosh të bëhesh skajshmërisht vetjak- kjo do të ishte lumturia.

Kur e pashë flamurin kombëtar

duke e larguar policia me urdhër të Ramushit nga 'rrethi', ashtu siç as kriminelin Sllobodan Millpsheviç nuk e ka larguar, e ndjeva barkun kur m'u rrotullua.

S'mbet rrëfim i të burgosurve politik që s'mu kujtua, sidomos i njërit prej tyre që në qelinë e Goli Otokut, kishte fjetur me minj e me gjarpërinj, në terrin e vetmisë së madhe, për atë flamur me shqiponjën e hamamit të Hyrës.

Kush jetoi më bukur, më gjatë, më me lavd dhe më mirë: Ai që u kalb në burg për flamurin, apo ai që tha 'leckë është flamuri'!

A ia ka marrë anën e keqja të mirës!

A po e mund djalli-Zotin!

E pse gjithë kjo vuajtje për njerëzit që s'e bëjnë kabull haramin, djer-sën e huaj, tradhtinë, kurvërinë, spiunazhin, krimin...

A janë këta njerëz të shëmtuar ndëshkimi ynë!

Pse asnjë të mirë në këtë vend nuk e arrin duke qenë i ndershëm.

E luta sot një shoqe 'eja shkojmë në kishën e Llapushnikut e ndezim nga një qiri e lutemi' ose afrohemi te naj teqe, del ku të del...

eeee Kim, më tha, lëre krejt, Krishti e di si jemi, me dasht na ndihmon...edhe pa e lutur.

Zoti më shumë po i plotëson dëshirat dhe kërkesat e njerëzve të këqij.

A nuk thatë ju se asgjë, bash asgjë, as e keqja dhe padrejtësia më e madhe, s'ndodh pa lejen e Zotit.

Kadri Veseli e shfrytëzoi gjendjen e Adem Demaçit për t'ia dhënë dhu-ratë flamurin për të cilin askush s'ka luftuar dhe s'ka bërë burg, prandaj askush s'ndjen dhimbje për të, që do të thotë, s'ndjen dashni.

Dashuri është të ndjesh dhembje

të shpirtit, e jo lezet për dikë. Vetëm dikush që të dhimbshet-e do.

Çdo gjë është dhimbje, e dashuria është dhimbja supreme.

Për ironi, në faqen e djathtë të bacës shiheshin disa njolla të kuqe, gjak.

Kosova gjithkrah dhe gjithkund ia ka gjetur vendin flamurit të Serbisë por nuk ka lënë vend për flamurin kombëtar.

Shko në Graçanicë largoje flamurin e Serbisë, n'guxofshë.

Ata s'janë si ne, ata të përgjakin!

Jo flamurin, por Ramush Haradinaj nuk lë t'zezë pa bë për pushtet. Nuk i tregojnë që s'ka shqiptar që nuk ndjehet i mërzitur dhe i pashpresë në këtë vend.

S'njoh njeri që nuk e urren me shpirt e që nuk e shan me fis e me farë.

10 vjet vetmi.

Shtet vetëm për ata që kanë vjedhur, shkatërruar, privatizuar, uzurpuar, varrë, falsifikuar, kurvëruar, korruptuar.

Të izoluar, edhe më të varfër, dyfish të lënduar, të frikësuar, të pamundur dhe të parrugëdalje.

10 vjet pa drejtësi.

Pavarësinë e Kosovës nuk e gëzoi populli që edhe pas 10 vjetësh mbetet më i varfëri në Evropë, por e gëzuan bandat kriminale dhe mafia politike.

Neverinë ndaj qeverisë Haradinaj e bën kaq të madhe edhe pafuqia e opozitës. S'kanë njerëzit ku t'i varin shpresat.

LDK pa kokë, e imiton kryetarin e saj të sëmurë, e gjithë partia sillen si pacientë të shtrirë për toke, dhjetë ditë heshtin e një ditë flasin pak, dhe bëjnë aq shumë gabime sa e duartrokin edhe gjestin e ultë të Kryeministrit me flamurin kombëtar, në vend se ta shfrytëzojnë rastin ta sulmojnë e ta bëj tokë.

Edhe sikur LDK s'do të kishte arsye ta sulmonte qeverinë Haradinaj, duhet t'i shpikë ato arsye dhe ta shfrytëzojë në maksimum neverinë qytetare ndaj kësaj qeverie, më të dësh-tuarën, më injoranten dhe më antikombëtarene që ka njohur deri sot Kosova.

E Albin Kurti ka filluar të zbutet. Kjo nuk na pëlqen. Po lejon ta 'zbusë' frika nga vetmia dhe izolimi. Dhe 'zbutja' as nuk po i ka hije. Dikujt nuk i ka hije urtësia.

Albini nuk po e fsheh nevojën për të zbritur nga 'qielli' e për t'u bërë 'njëri nga ata' që e fyen dhe e mashtruan.

Njeriu i 'madh' dhe serioz nuk shpreh nevojë publike për njerëz të ligë e të ultë që të flasin pas shpinës dhe të mashtrojnë, sepse kështu tregon se sa i vetmuar dhe i humbur ndjehet anipse nuk është.

Si mundet që një njeri të zotërojë kaq shumë gjuhë? Dhe si jeton ai me këtë? Ikonomu të tilla pyetje i duken "qesharake". Ai nuk ia ka bërë kurrë vetes ato. Dhe nuk e di nëse me zotërimin e 32 gjuhëve, mund të hysh në librin e rekordeve "Guinness"

Një ndërtesë gri në "Rue de Genève", në katin e shtatë, dhoma 07/01 në Bruksel. Në ekranin e kompjuterit të 51-vjeçarit, Janis Ikonomu, gjenden kontratat e tij të punës, të shënuara me ngjyra të ndryshme. Gjatë dy javëve të ardhshme, ai duhet të përkthejë dy tekste voluminoze me përmbajtje ligjore nga frëngjishtja e gjermanishtja, në greqisht. Kjo është në fakt ca e bezdisshme, por thotë se "ky është kontributi im për Europën", thotë ai në një gjermanishte perfekte. Interesante janë sidomos tri detyra: Komisioni European ka nevojë me urgjencë për përkthimin e dokumenteve konfidenciale nga gjuhët hebraike, kineze dhe azere. Këtë mezi e arrijnë shumë pak nga 2500 përkthyesit që ndodhen në BE. Ikonomu është më i miri nga të gjithë. Ai flet 32 gjuhë thuajse rrjedhshëm, e ndër to edhe disa gjuhë të vdekura tashmë, të cilat ai vijon t'i zotërojë pasivisht. Atë çka arrin koka e tij, ndoshta nuk ka gjasa ta hasësh të dytë në mbarë botën. Si mundet që një njeri të zotërojë kaq shumë gjuhë? Dhe si jeton ai me këtë? Ikonomu të tilla pyetje i duken "qesharake". Ai nuk ia ka bërë kurrë vetes ato. Dhe nuk e di nëse me zotërimin e 32 gjuhëve, mund të hysh në librin e rekordeve "Guinness". Në fillim ishte kureshtja. "Kjo është edhe fjala kyç për jetën time". Në plazhin e Kretës në Greqi, Jani i vogël dëgjonte zërat e huaj të turistëve, por ai nuk kuptonte dot gjë. Ai nuk luante futboll, nuk rrihej me shokët, e shumica e lëndëve në shkollë i jepnin bezdi. Ai më mirë do e gjente veten të zhytur në një botë fjalësh të panjohura.

NGA QEJFI MËSOI EDHE SUAHILI

Në moshën pesëvjeçare ai mësoi anglisht, shtatë vjeç zotëronte gjermanishten ("zonja Rosi, një gjermane në Kretë, ishte ajo që ia kishte mësuar"), e në moshën dhjetëvjeçare mësoi italishten ("një shok shkollë ia nisi ta mësonte, e unë - thotë ai - doja të isha më i mirë se ai"), në moshën 13-vjeçare rusishten ("më pëlqente Dostojevski, thotë"), 14 vjeç, mësoi gjuhën suahili, një dialekt nga gjuhët afrikanolindore ("thjesht nga qejfi") dhe 16 vjeç mësova turqishten.

"Nuk doja të kisha armiq, doja të flisja me to". Në Greqi në atë kohë nuk kishte libra për mësimin e turqishtes. "Prindërit e mi gjetën zonzjën Aishe, një arkitekte e emigruar nga Qiproja Veriore. Ajo ish-

JANIS IKONOMU

NË MOSHËN 20 VJEÇARE, DINTË 15 GJUHË



te shumë kërkuese". Por nuk është vetëm kjo kureshtje, që e ka bërë Ikonomu një të marrë pas gjuhëve të huaja. Edhe inteligjenca e tij, që i ka siguruar anëtarësinë në klubin ndërkombëtar të të talentuarve "Mensa", nuk mjafton për ta shpjeguar këtë fenomen. "Shokët e mi dëgjonin të gjithë të njëjtat këngë greke dhe hanin suflaqqe. Kurse unë doja t'i rrëshqisja suflaqqe, kulturës sime, rrënjëve të mia. Unë isha e kundërta e Odisëut". Kështu Ikonomu udhëton gjithnjë ndër gjuhë e kultura të kësaj bote. Deri më sot. Pas turqishtes, ai mësoi arabishten, u bë sufist, një ndjekës i mistikës islame. "Rregullat e një gjuhe janë pikënisja për mua. Unë dua të kuptoj gjithçka; të ngrënët, muzikën, fenë, dramën e një populli". Pasi një hop madhor: Ikonomu papritur u ndje i mahnitur nga India, studioi urdu, hindi dhe sanskritisht. Ai për 18 vjet me radhë ishte një vegjetarian rigoroz dhe jetonte sipas rregullave hindu.

SOT AI NUK BESON NË ASNJË PERËNDI

"Por nëna ime u çmend, e nisi të thoshte: 'Mjaft tani me këtë muzikën indiane. Dhe përse duhet të hash me gishta?' Prindërit e mi më kanë mbështetur gjithmonë, por tashmë boll ishte boll. Ndonjëherë mendoj se ata do të kishin qenë më të lumtur, nëse do kisha qenë një njeri fare normal e të dëgjoja popin grek". Megjithatë, Janis vijoi me të tijën. "Dikur më pas m'u bë e qartë: Ti nuk do të bëhesh kurrë një hindu i vërtetë". Sot Ikonomu nuk beson në asnjë Zot, ha mish e përdor pirunin e thikën e ndonjëherë pi edhe alkool. "Rëndësi ka të bësh gjëra të mira", thotë ai.



TASHMË AI DO TË MËSOJË EDHE SHQIPEN

Tashmë ai do të mësojë edhe shqipen. Vendi prej pak kohësh është kandidat për në BE. "Unë kam nevojë gjithnjë për një ngacmim", thotë ai. Synimi i tij: Në tri muaj të arrij të kuptoj lajmet në gjuhën shqipe. Ai nuk ka nevojë për një fletore fjalori. Ai përdor fjalorë elektronikë - dhe gërmon në internet në gjuhën e re. "Përqendrohëm me muaj të tërë vetëm te shqipja, mësoj fjalët, bëj lidhje diagonale, i memorizoj ato dhe i përdor në çast menjëherë, apo gjatë leximit të gazetave". A ka ndonjë emër për metodën e tij? "Përkushtimi total", thotë ai.

Ikonomu flet 21 nga gjithsej 24 gjuhët zyrtare të BE-së. "Lituanishten e ka harruar sërish, ndërsa për të mësuar galishten e maltezen, thotë se s'ka pasur kohë më në dispozicion". Por ai nuk kupton vetëm gjuhët moderne, por edhe disa nga ato të vjetrat. Latinisht po që po, por edhe gotishten, gjuhën maja, irlandishten e vjetër dhe persishten e vjetër. Dizertacionin, Ikonomu e shkroi në Harvard, ku trajtoi një tekst të vjetër të profetit Zarathustra, që u përmbodh në gjuhën avestite, një dialekt zbavitës i persishtes së vjetër.

"Gjuha është si dashuria", thotë ai. "Nëse ti dashurohesh me dikë, do ta njohësh edhe gjithë historinë e tij, të takosh prindërit e tij, të vizitosh shkollën ku ai ka mësuar. Një gjuhë për mua nuk është vetëm e tashmja, por edhe e shkuara". Para pak kohësh, Ikonomu bëri edhe një zbulim. Ai zbuloi se fjala "shiu" në të gjitha gjuhët sllave rrjedh nga persishtja e vjetër. "Kjo gjë më ka mahnitur aq shumë, sa që kam folur me kënaqësi me dikë rreth saj. Unë mund të flisja po me aq kënaqësi e zell edhe për shkrimet e vjetra maja në muzeun e qytetit të Meksikos, apo rreth mësimëve të mbretit Dareios, i cili jetoi 500 vjet para Krishtit. Vetëm se nuk më dëgjon kush. Ndonjëherë ndihem i vetmuar, por kjo punë është thjesht kështu".

KATËR-PESË ORË GJUMË MJAFTOJNË

Megjithatë, Ikonomu nuk është i vetmuar. Ai ka miq dhe familje. Ai është i martuar me një grua me emrin Tomek, që vjen nga Polonia. "Unë nuk jam idiot. Kam miq të cilët as që i kanë dëgjuar ndonjëherë fjalët gotik apo san-

Të gjithë ata që flasin disa gjuhë të huaja, kanë një nivel të lartë inteligjence. Shumica e njerëzve mësojnë deri në 3 gjuhë të huaja gjatë jetës së tyre, por ky njeri është krejt ndryshe. Janis Ikonomu di të flasë 32 gjuhë të huaja dhe të gjitha i ka mësuar vetëm duke lexuar, në mënyrë autodidakte. Janis ka lindur në Greqi, dhe që në moshën 20 vjeçare ai dinte 15 gjuhë. Janis bën pjesë tek një grup i vogël njerëzish që quhen hiperpoliglotë, të cilët kanë aftësinë për të mësuar si të flasin rrjedhshëm shumë gjuhë.


skritisht. Ne dalim me njëri-tjetrin e zbavitemi". Por dikur, kur miqtë largohen e Tomek rri në shtrat, Ikonomu zhytet në botën e tij. Para kompjuterit të tij ai sheh kanale televizive hungareze apo kineze, gjithçka që ndodh në atë moment. Çaton me orë në rusisht, turqisht, bullgarisht, apo me ndonjë etiopian që flet gjuhën amarike. Kjo punë ndodh çdo natë. Rreth orës katër të mëngjesit, Ikonomu shkon në shtrat e fle katër deri pesë orë. Kjo nuk është e mirë për shëndetin e tij. "Por kështu unë qëndroj i lidhur me gjuhët. Nuk më duhet të shfletoj vazhdimisht fjalorët, s'jam më nxënë. Unë jam dikushi që i përdor gjuhët në jetën reale".

METODA: PËRKUSHTIM TOTAL

Për Ikonomu, së pari janë dokumentet zyrtare, të cilat duhet t'i përkthejë, dhomat mbarëbotërore të çatit, televizioni në internet, programet radiofonike në iPod. Ai i dëgjon ato në mëngjes dhe në mbrëmje rrugës për në punë, gjithnjë në gjuhë të ndryshme. Për momentin ai po dëgjon në kinezisht. "Pikërisht kjo është shumë e rëndësishme për mua". Komisioni European po i kërkon gjithnjë e më shumë përkthimet e tij nga kinezishtja. Në zyrë gjendet një tabelë mësimore me karakteret e shenjave kineze të shkrimit. "Gjuha kineze është gjuha ime e preferuar. Ajo është totalisht e ndryshme, mali e Everestit për evropianët". Në Kinë ai ka qenë disa herë. Çdo herë që shkon atje, ai mëson më shumë. Kostot ia pagan komisioni. Zakonisht. Në disa vende, gjuhën e të cilave ai e flet, përkundrazi, Ikonomu akoma nuk ka qenë. Në Etiopi apo në Kongo për shembull. "Unë thjesht nuk kam kohë".

(Marrë nga "Die Welt")

Gjithçka nisi me zgjedhjet në SHBA, që u fituan nga Trump si dhe famëkeqen Russiagate: episode që e zhvendosën vëmendjen tek fenomeni i lajmeve të rreme. Më pas algoritmi i ri, që penalizon lajmet. Dhe në fund, shifrat e fundit, që tregojnë rënie të kohës që përdoruesit kalojnë në platformë, si dhe largim drejt rrjeteve të tjera



FEJSBUKU ËSHTË NË TELASHE

Fejsbuku, kolosi prej dy miliardë përdoruesish që pikërisht mbi të dhënat i ka ngritur themelet e tij, ndodhet përballë një vështirësie ligjore që mund të shkaktojë një efekt domino shumë të madh. Dhe pasojat e mundshme të të cililit janë të pallogaritshme. E gjitha nisi nga një vendim i një gjykate në Berlin, që në fakt i jep një shuplakë të fortë lëvizjeve aktuale mbi të dhënat personale që aplikohen prej Fejsbukut. Një gjykatës gjerman, pas kërkesave të një shoqate konsumatorësh (Vzvb), ka vendosur që do të jetë e mundur të regjistrohesh në rrjetin social të Mark Zuckerbergut edhe pa asnjë detyrim për të ofruar të dhënat personale autentike. Domethënë: kush dëshiron të regjistrohet me një nofkë të rremë mund ta bëjë. Dhe nuk do të konsiderohet më klauzola, që përmbahet në kushtet e përgjithshme të rrjetit social, sipas të cilës kompania me seli në Menlo Park mund t'u japë kompanive të treta të dhënat personale dhe imazhin e profilit. Vendimi i gjykatës berlineze i ka shpallur të pavlefshme 8 klauzola të kushteve të përgjithshme dhe 5 parakushte. Për momentin nuk është zbardhur ende dhe kolosi ka bërë të ditur se do ta apelojë këtë vendim. Por përshtypja është që në Berlin ka re të zymta për Fejsbukun.

"Fejsbuku i fsheh preferencat që nuk favorizojnë mbrojtjen e pri-

vatësisë në qendrën e vet private, pa dhënë informacione të mjaftueshme për këtë gjatë regjistrimit të përdoruesve", ka thënë avokati i shoqatës së konsumatorëve, Heiko Duenkel. Një zëdhënës i kompanisë së Zuckerbergut ka përsëritur angazhimin maksimal për të respektuar rregullat, edhe duke patur parasysh diktatin e ri normativ evropian që vjen në pranverë: "po punojmë për të garantuar që linjat tona udhërrëfyese të kuptohen lehtësisht dhe që shërbimet e ofruara nga Fejsbuku të pajtohen me ligjet", ka thënë ai për agjencinë e lajmeve Reuters.

ZUCKERBERG NË TELASHE

Ndërkohë ka shkaktuar shumë debate kopertina e të përjavshmes amerikane "Wired", kushtuar pikërisht Fejsbukut, që paraqet një Mark Zuckerberg me fytyrë të dëmtuar pas një ndeshje boksi. Një metaforë e cila përmbledh dy vitet e fundit: 24 muaj në të cilët Fejsbuku ka përfunduar shumë herë në qendër të polemikave. Gjithçka nisi me zgjedhjet në SHBA, që u fituan nga Trump si dhe famëkeqen Russiagate: episo-

de që e zhvendosën vëmendjen tek fenomeni i lajmeve të rreme. Më pas algoritmi i ri, që penalizon lajmet. Dhe në fund, shifrat e fundit, që tregojnë rënie të kohës që përdoruesit kalojnë në platformë, si dhe largim drejt rrjeteve të tjera. Për dy vitet e fundit, artikulli i Wired përcakton një vijë kohore precize, që nisi në mars 2016 me largimin e Benjamin Fearnow, një prej gazetarëve që merrej me "Trending Topics". Fearnow kishte përshkruar për Gizmodo një mjedis ku "lajmet me orientim konservator hiqeshin sistematikisht". Më pas, në qershor të po atij viti, akuzat e Rupert Murdoch që e sheh Fejsbukun si një kërcënim për ekzistencën e medias. Dhe më tej historitë e tjera: deri tek Russiagate (me pranimin e Zuckerbergut) dhe algoritmin e ri. Një duel prej ringu, ku Zuckerbergu ka luftuar me shumë kundërshtarë.

LAJMET E RREME LARGOJNË REKLAMAT

Ndërkohë, pikërisht në orët e fundit, një tjetër kërcënim vjen prej kolosit të reklamave Unilever. Kompania e dytë më e madhe në botë u

ka bërë të ditur Fejsbukut dhe Gugëllit se do të ndalë reklamimin në platformat e tyre, nëse nuk bëjnë më shumë për të luftuar lajmet e rreme. Sa për të krijuar një ide, vitin e kaluar kompania ka hedhur në Fejsbuk 9 miliardë dollarë. Dy kolosëve u kërkohet të rrisin transparencën, për të mbrojtur të miturit nga përmbajtje të rrezikshme: "Duke qenë një prej kompanive kryesore të reklamave në botë, nuk mund të kemi një mjedis ku klientët tanë nuk i besojnë atyre që shohin online", thuhet në një mesazh të Keith Weed, shefi i marketingut të kompanisë shumëkombëshe. "Unilever nuk do të investojë në platforma apo mjedise që nuk mbrojnë fëmijët tanë, apo krijojnë ndarje në shoqëri dhe nxisin zemërim e urrejtje. Do i japim përparësi vetëm investimeve në platforma të përgjegjshme që janë të angazhuara të krijojnë një impakt pozitiv në shoqëri". Nga njëra anë, Fejsbuku duhet të luftojë lajmet e rreme. Nga ana tjetër është detyruar nga një gjykatë që të pranojë përdorues me të dhëna false. Një patate e nxehtë domethënë. (Il Sole 24 Ore)

LOJËRAT OLIMPIKE: Numër rekord i prezervativëve u jepen atletëve

Atletët që garojnë në Lojërat Olimpikë Dimërore, Pyeongchang të Koresë së Jugut, kanë pranuar ditë më parë 119 mijë prezervativë - numër rekord për këto lojëra. Sipas numrit të pjesëmarrësve, secilit garues i kanë rënë nga 38 prezervativë, duke iu dhënë mundësinë që të "ngrohen" sapo pak në lojërat të cilat mund të jenë më të ftohtat në 20 vjetët e fundit shkruan BBC. Prodhuesi që ka dhuruar prezervativët, nuk pret që të përdoren të gjithë. Nëse ajo do të ndodhte do të në garën që zgjat vetëm 16 ditë, do të ishte arritje. Me gjithë sasinë e madhe të prezervativëve të dhuruar, ka pasur atletë që e kanë vënë në dyshim cilësinë e tyre. "Mendoja se ata do të jenë me rrathe olimpikë, apo me ngjyra të ndryshme, por jo. Është mit", ka thënë skitari Adam Rippon.



Miguel Castillo, një noter në pension nga Valencia, nuk është studenti i zakonshëm i programit "Erasmus". Sidoqoftë, babai i 3 vajzave dhe gjysh i 7 nipërve e mbesave, po përgatitet të nisë eksperiencën e re universitare në Itali.

Aktualisht një student historie në Universitetin e Valencias, 80-vjeçari Castillo do të kalojë semestrin e tij të ardhshëm në Verona, falë programit të shkëmbimit eu-

Studenti i pazakontë i programit "Erasmus"

80-vjeçari, që do të ndajë eksperiencën "Erasmus" me bashkëshorten e tij, thotë se nipërit dhe mbesat e kanë mbështetur që nga fillimi, ndaj inkurajon edhe persona të tjerë të moshës së tij të mos mbyllën në shtëpi, por të hapen për botën



ropian. Ai u reregjistrua në universitet për shkak se jeta tipike e një pensionisti, që përfshin kujdesin për nipërit e mbesat, shëtitjet,

lojën e golfit dhe bërjen e pak ushtrimeve, nuk ishte e mjaftueshme për të. Një atak kardiak i pasuar nga një "bypass" i katërfishtë i dha

atij shtytjen përfundimtare, që i duhej për t'u rikthyer në bankat e shkollës.


"Ndoshta kjo ishte drita që

ndriçoi sadopak jetën time", thotë ai. "I thashë vetes, duhet bërë diçka tjetër. Nuk mund të qëndroj kësh-tu dhe kjo më dha kurajon të shikoja se ku mund të studioja". Castillo, jo vetëm që ka rigjetur dashurinë e tij për studimin në një moshë të vonë, por është bërë edhe i famshëm. Telefoni i 80-vjeçarit nuk ka ndaluar së tringël-luari, me një pafundësi mediash që duan të shkruajnë historinë e tij, pas regjistrimit në programin "Erasmus".

80-vjeçari, që do të ndajë eksperiencën "Erasmus" me bashkëshorten e tij, thotë se nipërit dhe mbesat e kanë mbështetur që nga fillimi, ndaj inkurajon edhe persona të tjerë të moshës së tij të mos mbyllën në shtëpi, por të hapen për botën. "Ne mund të kontribuojmë shumë dhe të fitojmë shumë nga shoqëria", tha ai.

KOSOVA FALËNDERON SHTETET QË E KANË NJOHUR PAVARËSINË

Më 17 shkurt 2018, në orën 22:00 para shikueseve dhe qytetarëve të Kosovës do të performojë këngëtarja më famë botërore Rita Ora. Seanca solemne për 10-vjetorin e Pavarësisë do të mbahet të dielën



Në pritjen e Ministrit të Jashtëm të Gjermanisë nga presidenti i vendit, Hashim Thaçi, para zyres së tij është vendosur një simbol me numrin 10-të për 10 Vjetorin e Pavarësisë, ku janë përfshirë të gjithë flamujt e shteteve që e kanë njohur Kosovën, së bashku falënderimet në gjuhën e tyre.

I kontaktuar nga KosovaPress, Adil Behramaj nga Këshilli Organizativ ka thënë se kjo ka qenë një formë simbolike e shprehjes së

mirënjohjes në këtë dhjetëvjetor për shtetet që na kanë njohur dhe vazhdojnë të na mbështesin në forcimin e subjektivitetit tonë shtetëror.

“Kjo ikonë sot është vendosur në Presidencë, por të ngjashme prej nesër do të vendosen edhe në kabinetin e kryeparlamentarit Veseli dhe të kryeministrit Haradinaj. Është një formë simbolike e shprehjes së falënderimit tonë

për njohjen dhe për përkrahjen e vazhdueshme të tyre”, ka thënë Behramaj.

Ndërkohë, Këngëtarja më famë botërore, Rita Ora do të marrë pjesë në manifestimin qendror që do të organizohet në Prishtinë, për 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. Pjesëmarrjen e yllit botëror të pop muzikës, me prejardhje nga Kosova, e ka konfirmuar për Radion Evropa e Lirë,

Adil Behramaj nga Këshilli Organizativ për shënimin e 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës. “Mund të konfirmoj se më 17 shkurt 2018, në orën 22:00 para shikueseve dhe qytetarëve të Kosovës do të performojë këngëtarja më famë botërore Rita Ora” ka thënë Behramaj. Shënimi i 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës ka filluar me aktivitete të ndryshme. Ndërkaq manifestimi qendror do të zhvillohet më 17 shkurt.

Seanca solemne për 10-vjetorin e Pavarësisë do të mbahet të dielën, ndërsa në seancë pritet të marrë pjesë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.

10 vjetori i Pavarësisë do të mbledhë deputetet të dielën, ashtu siç kishte ndodhur kur ishte shpallur. Gazeta Express ka marrë vesh që seanca solemne nuk do të mbahet të shtunën, më 17 shkurt, por të nesërmen, më 18, si simbolikë e së dielës kur Kosova u shpall shtet i pavarur.

Gjithashtu, të dielën në seancë, ndër të tjerët, pritet të marrë pjesë edhe kryeministri shqiptar Edi Rama.



Gabriel: Kosova, kusht për Serbinë

Serbia nuk mund të behet pjesë e Bashkimit Europian nëse nuk njeh pavarësinë e Kosovës. Kështu është shprehur ministri i Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Sigmar Gabriel, mbrëmjen e së mërkurës, pas takimit me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj në Prishtinë. “Në Beograd i bëra të qartë Serbisë se nëse dëshiron të ecë drejt Bashkimit Evropian, sundimi i ligjit është kusht parësor, por, natyrisht edhe pranimiti i pavarësisë së Kosovës. Kjo është e rëndësishme për Serbinë, pasi në të kundërt nuk do të mund të bëhet anëtarë e BE-së. Por, në të njëjtën kohë është edhe në interes të Kosovës. Kjo është një çështje ku fitojnë të gjithë.”

Gabriel theksoi se arritja e një marrëveshjeje është e vështirë, por në fund të dyja palët do të kenë përfitime. Ai siguroi se Gjermania do vazhdojë ta mbështesë Kosovën në përpjekjet për të për të siguruar njohjen e pesë vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilët ende nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Deklarata e ministrit gjerman në Prishtinë vjen pas vizitës në Beograd, ku bisedoi me qeverinë serbe mbi proceset integruese të Ballkanit Perëndimor.

Ambasada Amerikane kundër idesë për shkëmbimin e territoreve

Ambasada Amerikane në Prishtinë ka dalë kundër idesë për shkëmbim territore, një iniciativë kjo, në të cilën janë përfshirë liderët e Kosovës. “Ne nuk përkrahim shkëmbimin e tokave apo vendosjen e precedentëve që do të shkaktonin më shumë probleme se sa që do të zgjidhnin, por të gjitha palët duhet të jenë kreative për të gjetur një zgjidhje”, kanë thënë nga ambasada amerikane në një përgjigje për Gazetën Express.



Kjo Ambasadë thekson se Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të mbështesin fuqimisht dialogun mes Kosovës dhe Serbisë që lehtë-

sohet nga BE-ja, dhe inkurajon të dyja palët që të shpejtojnë përpjekjet e tyre për të normalizuar plotësisht marrëdhëniet mes tyre.

“Ne jemi të gatshëm që të dëgjojmë, të ndihmojmë, dhe të jemi kreativë në mbështetjen e përpjekjeve për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse e që është mënyra e vetme për të hapur rrugën drejt të ardhmeve perëndimore të Kosovës dhe Serbisë”, vlerëson ambasada.

Universiteti i Prishtinës shënon 48 vjetorin e themelimit

Me rastin e shënimit të 48 vjetorit të themelimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se sot në ditët kur po shënohet 10 vjetori i Pavarësisë së Kosovës, duhet unitet politik dhe qytetarë. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi tha se universiteti që mban emrin e Hasan Prishtinës në periudhë gjysmë shekulli ka dhënë profesorë, studentë, akademikë, heronj, dëshmorë për lirinë dhe pavarësinë e



Kosovës. “Liria dhe pavarësia janë vlera të pandashme me vlerat e Universitetit të Prishtinës dhe liria

duhet të pasurohet dhe të përtërihet. Kosova ka qenë është dhe do të mbetet Evropë dhe perën-

dim këtë nuk duhet ta harrojmë kurrë, vendi i Kosovës e ka vendin në NATO. Sot kur po shënojmë 10 vjetorin e pavarësisë na duhet unitet politik e qytetarë”, tha ai. Rektori i Universitetit të Prishtinës, Marjan Demaj, populli i Kosovës këto ditë është duke i shënuar tri ngjarje, 550 vjetorin e vdekjes së Skënderbeut, dhjetëvjetorin e pavarësisë së vendit dhe 48 vjetorin e themelimit të Universitetit të Prishtinës. Sipas tij, stafi akademik jo vetëm që po shkëlqen me

mësimdhënie, studime por ata po nderohen edhe në gara botërore duke e ngritur lartë Kosovën në sferën akademike botërore. “UP është madhështor, të tillë e ka dëshmuar historia dhe të tillë e kanë bërë studentët. Universitetit i Prishtinës është Kosova pa ndryshim të UP-së nuk ka ndryshim të Kosovës. UP asnjëherë nuk ka qenë më mirë se sa që është tani që nga pas lufta”, tha ai.

Universiteti i Prishtinës është themeluar në vitin 1970.



• I akuzuar për kryerjen e sulmit, Nicolas Cruz

TERROR NË FLORIDA

TË PAKTËN 17 PERSONA JANË VRARË NË NJË SHKOLLË

Të paktën 17 persona janë vrarë në sulm me armë zjarri në shkollën Stoneman Douglas në Parkland, Florida. I dyshuari, i akuzuar për kryerjen e sulmit të përgjakshëm është emëruar nga mediat amerikane si Nicolas Cruz, 19 vjeçar. Policia ka njoftuar se Cruz ka qenë më parë nxënës i shkollës, i cili ishte përjashtuar. Ai njihet nga shokët si një njeri "i çmendur për armët" dhe veprimi si në filma duke shkaktuar një tragjedi të madhe. 19-vjeçari i cili ishte dëbuar nga Shkolla e Mesme mbante një maskë në fytyrë dhe hyri në shkollë duke ndezur alarmin e zjarrit, kështu që fëmijët do të dilnin nga klasat dhe aty ai filloi masakrën.

Sulmuesi është në paraburgim. Është raportuar se i njëjti ka lëshuar



“Lutjet dhe ngushëllimet tona janë me familjet dhe të afërmit e personave të cilët kanë humbur jetën në sulmin e tmerrshëm në Florida. Asnjë nxënës, mësues ose ndonjë tjetër nuk duhet të ndjejë veten i pasigurt në një shkollë amerikane”, ka shkruar Trump.

alarmin për zjarr duke shkaktuar kaos në shkollë para se të niste të shtënat, kanë thënë zyrtarë të zbatimit të ligjit për CBS News. Nxënësit janë detyruar të fshihen në klasa derisa policia ka kërkuar në ndërtesë. Sherifi i Broward, Scott Israel u ka thënë gazetarëve, se Cruz ka filluar të shtënat jashtë shkollës duke vrarë tre persona. Ai më pas ka hyrë në ndërtesë duke vrarë 12 të tjerë. Dy persona kanë vdekur pasi kanë arritur në spital. Sherifi Israel, incidentin e ka cilësuar "katastrofik", dhe se "nuk ka fjalë".

"Presidenti është njoftuar për të shtënat në shkollën në Florida", ka thënë zëvendës-sekretarja për shtyp në Shtëpinë e Bardhë, Lindsay Walters. "Jemi duke e vëzhguar situatën. Lutjet tona janë me të

prekurit", ka thënë ajo. Ndërsa presidenti amerikan, Donald Trump përmes një postimi në Twitter ka thënë se askush nuk duhet të ndihet i pasigurt në shkollat amerikane. "Lutjet dhe ngushëllimet e mia shkojnë për viktimat e sulmit të tmerrshëm në Florida. Asnjë fëmijë, mësues apo dikush tjetër nuk duhet të ndihet i pasigurt në një shkollë amerikane".

Masakra që ndodhi në shkollën "Marjory Stoneman Douglas" në Parkland të Floridas tronditi mbarë opinionin publik. Në pamjet e fundit të publikuara shihen nxënësit që i kanë shpëtuar masakrës duke u nxjerrë nga klasa nga policët, derisa afër tyre kishte të vrarë që qëndronin të shtrirë të mbuluar në gjak.

Miliarda dollarë për rindërtimin e Irakut



Bagdadi pret shumë nga komuniteti ndërkombëtar për të përballuar këtë ndihmë titanike, vlerësuar prej 88 miliardë dollarësh

Aleatët e Irakut janë angazhuar për të zhbllokuar miliarda dollarë në kredi dhe investime për të ndihmuar për rindërtimin e vendit, pas tre vitesh të një lufte shkatërruese kundër grupit të Shtetit Islamik. Në ditën e tretë dhe të fundit të konferencës ndërkombëtare në Kuvajt për rindërtimin e Irakut, premtimet për ndihma arrijnë në rreth 25 miliardë dollarë. Bagdadi pret shumë nga komuniteti ndërkombëtar për të përballuar këtë ndihmë titanike, vlerësuar prej 88 miliardë dollarësh. Prekur prej dekadash nga luftrat e vazhdueshme dhe një embargo afatgjatë, Iraku shpalli në muajin dhjetor fitoren ndaj Shtetit Islamik, që kishte pushtuar në një të tretën e vendit që prej vitit 2014. Por, kërcënimet për atentate nuk është zhdukur ende, mijëra infrastruktura janë shkatërruar dhe 2,5 milionë persona janë zhvendosur. Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres i kërkoi komunitetin ndërkombëtar të mbështeste përpjekjet për rindërtimin e Irakut. "Mbarë bota iu detyrohet për luftën tuaj kundër kërcënimit botëror që përbën ISIS", theksoi Guterres. "Ka ardhur koha të shprehim mirënjohjen dhe solidaritetin tonë me popullin irakian", shtoi ai. Pjesa më e madhe e ndihmës së premtuar tashmë vjen nga Britania e Madhe (një miliardë dollarë në vit në kreditë për eksport në 10 vjet) dhe Turqia (pesë miliardë dollarë), nga kontributet që ndahen në kredi dhe investime. Nga ana e saj, shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini njoftoi një mbështetje prej 400 milionë dollarësh për projektet humanitare dhe të zhvillimit.

S-400 vështirë do të integrohen në sistemin e NATO-s

Për Turqinë do të jetë e komplikuar t'i integrojë sistemet ruse për mbrojtje antiraketore S-400 në sistemin për mbrojtje antiraketore të NATO-s, deklaroi mbrëmë sekretari i përgjithshëm i Aleancës, Jens Stoltenberg. "Turqia gjithashtu, bashkëpunon me dy vende-anëtare të NATO-s, Francën dhe Italinë për krijimin e sistemit për mbrojtje antiraketore në bazën e komplekseve SAMP-T", deklaroi Stoltenberg pas përfundimit të

ditës së parë nga mbledhja e ministrave të Mbrojtjes së Aleancës. Ai potencoi se NATO-ja i përshëndet përpjekjet për krijimin e mbrojtjes antiraketore në bazë të komplekseve të SAMP-T. "Kur ka të bëjë me integrimin e sistemeve turke në sistemin për mbrojtje antiraketore të NATO-s, e dukshme është se SAMP-T sistemet evropiane lehtë do të integrohen, përderisa ajo do të jetë e komplikuar të arrihet me S-400", vlerësoi Stolten-

berg. Nga fundi i janarit ministri i Mbrojtjes, gjenerali Sergej Shoigu kumtoi se është nënshkruar marrëveshje për dorëzimin e sistemit raketor për mbrojtje S-400 për Turqinë, Shoigu theksoi se ende ka vende të interesuara, si dhe se Turqia është vendi i dytë i NATO-s, e cila ka blerë sistem raketor mbrojtës. Në arsenalin e saj edhe Greqia ka sisteme antiraketore ruse, por nga modeli më i vjetër S-300.

Çdo i 6-ti fëmijë jeton në rajonet e konfliktit

Organizata bamirëse "Save the Children" në një raport të saj bën të ditur se çdo i 6-ti fëmijë në botë jeton në rajonet e konfliktit



Organizata bamirëse "Save the Children" në një raport të saj bën të ditur se çdo i 6-ti fëmijë në botë jeton në rajonet e konfliktit. Në raportin e publikuar me titull "Ndikimi i luftës te fëmijët: Koha për ta ndaluar dhunën ndaj fëmijëve në rajonet e konfliktit", thuhet se çdo

i 6-ti fëmijë në botë jeton në luftë ose në rajonet e konfliktit. Numri i fëmijëve të cilët jetojnë në rajonet e prekura nga përlëshjet nga fillimi i viteve 1990 me një rritje prej 75 për qind ka arritur në 357 milionë

dhe se 165 milionë prej tyre jetojnë në "rajonet e konflikteve intensive". Në raportin e miratuar edhe nga Kombet e Bashkuara (OKB), theksohet se që nga viti 2010 e deri më tani ka një rritje prej 300 për

qind në nivelin e vdekjeve dhe të plagosjeve të fëmijëve. Duke nënvizuar se Siria, Afganistani dhe Somalia janë vendet më të rrezikshme për fëmijët, në raport thuhet se çdo i dyti nga 5 fëmijët në Lindjen e Mesme dhe se çdo i pari nga 5 fëmijët në Afrikë jetojnë afër 50 kilometra në rajonet ku ndodhin konfliktet. "Taktikat e rrethimit dhe të lënies në uri për dorëzimin e një grupi të armatosur apo të gjithë komunitetit, vazhdon në rritje të përdoret kundër civilëve si një armë e luftës", thuhet në raport, duke shtuar se fëmijët në rajonet e konfliktit po përjetojnë trauma shumë të rënda psikologjike dhe se këto do të ndikojnë

negativisht në brezat e ardhshëm. "Save the Children" thekson se përkundër standardeve të së drejtës ndërkombëtare të krijuara për mbrojtjen e fëmijëve, në gjithë botën "g gjithnjë e më shumë po përdoren taktikat e pamëshirshme si armatimi i fëmijëve dhe dhuna seksuale". Sipas raportit fëmijët në rajonet e konfliktit mbeten të privuar nga shërbimet shëndetësore dhe arsimore dhe ushqehen në mënyrë të pamjaftueshme. Në rezultatet e raportit ende nuk është reflektuar drama e përjetuar nga fëmijët muslimanë të Arakanit në Mianmar, për shkak se ende nuk janë përfunduar të dhënat për vitin 2017.

INICIATIVA E KËSHILLTARËVE TË PPD-PDP TË GOSTIVARIT DHE TETOVËS DORËZUAR GJYKATËS KUSHTETUESE

KUR VOTA SHQIPTARE NUK KISHTE VLERË!



Nga Qerim LITA

Në ciklin e botimeve të dokumenteve me peshë historike për shqiptarët në përgjithësi, në mënyrë të veçantë për shqiptarët në Maqedoni, kësaj radhe po i publikojmë dy dokumente të rralla, që bëjnë fjalë për një politikë diskriminuese të pushtetit maqedonas ndaj kombit shqiptar. Nëse deri më tash kemi publikuar dokumente të cilat pasqyrojnë politikën diskriminuese politike, etnike, arsimore e kulturore të këtij pushteti ndaj shqiptarëve, në këto dy dokumente bëhet fjalë për një diskriminim tjetër, atë zgjedhor, përkatësisht mohimin e qytetarëve shqiptarë që përmes zgjedhjeve të fshehta e të lira të përcaktojnë përfaqësuesin e vet.

Një dukuri e tillë ndodhi menjëherë pas zgjedhjeve të para "demokratike" në RS të Maqedonisë, parlamentare e lokale të cilat u mbajtën gjatë muajve nëntor-dhjetor 1991. Siç dihet në këto zgjedhje partitë politike shqiptare, Partia për Prosperitet Demokratik dhe Partia Demokratike Popullore, në tre komuna: Tetovë, Gostivar e Dibër, fitoi shumicën absolute të këshilltarëve. Sipas Ligjit të atëhershëm për vetadministrim lokal, kryetari i Komunës zgjidhet nga këshilli komunal, kuptohet me shumicë të thjeshtë. Nëse kjo procedurë u krye në Komunën e Dibërës, në dy komunat tjera kjo çështje morri karakter politik e etnik, për arsye se kjo e drejtë u mohua këshilltarëve shqiptarë, përkundër faktit se përbënin shumicën dërmuese e punëve të kuvendeve të komunave Tetovë dhe Gostivar.

"GJYQIT KUSHTETUES TË MAQEDONISË, SHKUP"

Në mbledhjen e grupit të këshilltarëve nga PPD-ë dhe PDP-ë, të mbajtur më datë 1 qershor të vitit 1991 u soll konkluzioni që Beqir Iseni, të dorëzoj,


INICIATIVË për vlerësimin e kushtetueshmërisë e ligjshmërisë së Vendimit për themelimin e këshillave ekzekutive për kryerjen

PPD-PDP në Tetovë, Gostivar e Dibër fitoi shumicën absolute të këshilltarëve. Sipas Ligjit të atëhershëm për vetadministrim lokal, kryetari i Komunës zgjidhet nga këshilli komunal, kuptohet me shumicë të thjeshtë. Nëse kjo procedurë u krye në Komunën e Dibërës, në dy komunat tjera kjo çështje morri karakter politik e etnik, për arsye se kjo e drejtë u mohua këshilltarëve shqiptarë, përkundër faktit se përbënin shumicën dërmuese

e punëve të kuvendeve të komunave Tetovë dhe Gostivar.

Gjyqi Kushtetues i Maqedonisë është i autorizuar dhe i obliguar t'i përcjell dukuritë me interes për realizimin e kushtetueshmërisë e ligjshmërisë, dhe besojmë se vendimi është shpallur publikisht dhe gjithësi se gjyqi duhet ta merr në shqyrtim, nëse jo për diçka tjetër, vetëm për atë se është diçka e pazakontë në sjelljen dhe nuk ka praktikë së paku vendime të tilla të sillen që nga ana e qeverive të suspendohen kuvendet. Qeveria e RSM-së, më datë 4 maj 1991 ka sjell vendim për themelimin e këshillave ekzekutive për kryerjen e punëve të kuvendeve Tetovë e Gostivar, nr. 23-948/1, ndërsa mbi bazë të nenit 14-a nga Ligji Kushtetues për zbatimin e Amendamenteve 57-80 nga Kushtetuta e RSM-së.

Suspendim të kuvendeve të Komunave nuk mund të zbatohet asnjë organ pa u shpall gjendja e jashtëzakonshme për atë territor. Qeveria edhe pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund ta zbatoj për arsye se nuk është kompetente. Kush mund të shpall gjendje të jashtëzakonshme vlerësojmë se nuk ka nevojë të sqarohet, për arsye se Kushtetuta është e qartë. Me sjelljen e aktit të këtu në mënyrë më drastike shkelen parimit kushtetues për rezultatet nga zgjedhjet dhe vendosjen e pushtetit sipas atyre rezultateve. Qeveria i autorizon këto këshilla ekzekutive diç më tepër se sa kanë të drejtë kuvendet tjera, të zbatohen vendimet për ndërmarrjen e punëve nga organet e ad-



ministratës komunale. Nëse këshillat kanë karakter të perkohshëm duhet të përcaktohet edhe koha se deri kurr do të administrojnë, ndërsa në nenin 2 kjo nuk është thënë. Këta këshilla a janë të pavarura ose nuk janë dhe a thua punët e mëtutjeshme i ka ndërmarrë Qeveria ose në pajtim me Vendimin e Kuvendit përcaktohen këshillat? Nëse kanë karakter të perkohshëm atëherë nuk mundet të autorizohen për kryerjen e të gjitha ato punët të cilat janë paraqarë në vendim. Ato janë të autorizuar të sjellin Statut ndërsa statutin mund ta sjellin vetëm kuvendi në procedurë të përcaktuar. Ato këshilla janë të autorizuar ndër të tjerave edhe të kryejnë autorizimi për lidhjen e kurorëzimeve. Me ligjin për kurorëzim qartë është përcaktuar se kurorëzimi lidhet para Kryetarit të Kuvendit ose nga këshilltari i autorizuar nga ai, kjo nënkupton se nëse nuk është këshilltar nuk mundet të autorizohet nga askush e aq më pak nga personi i pautorizuar. Gjithsesi personi mund të përcjell aq të drejta sa i posedon edhe vet ai. Lidhjet e kurorëzimeve janë të paligjshme para këtyre qytetarëve. Për këtë në mënyrë të veçantë bëjmë me dije për arsye se ka autorizime të shumta të cilat më pas do të paraqiten si jo valide dhe si të tilla të pavlefshme, pra vendimi i këtuillë do të ketë edhe pasojë të mëdha. Nga sa u shtrua më sipër lusim të ngrihet iniciativë dhe të caktohet debat publik në të cilën do t'i risqarohet shkeljet.

Deponoi Beqir Iseni, nga Tetova, rr. "29 Nëntori" nr. 46"

"SEKRETARIT TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË LËNDA: Kërkohe akti dhe sqarimi i përgjithshëm

Gjyqit Kushtetues të Maqedonisë i është dorëzuar iniciativë për nismën e procedurës për vlerësimin e kushtetueshmërisë e ligjshmërisë së Vendimit për themelimin e këshillat ekzekutiv për kryerjen e punëve të komunave Tetovë e Gostivar, nr. 23-948/1, e sjell nga qeveria e Republikës së Maqedonisë më 4 maj të vitit 1991, për arsye se është sjell nga organi i cili nuk ka qenë kompetent të sjell akte me përmbajtje të tillë, që parashikon suspendimin e kuvendeve të komunave ndërsa kjo ka mund të kryhet vetëm në kushte të gjendjes së jashtëzakonshme në territor të caktuar, që paracaktuaka anulimin e rezultateve nga zgjedhjet për arsye se nuk është përcaktuar koha për të cilën themelohen këshillat drejtuese dhe që parashohin këshillat drejtuese të kenë më shumë të drejta se sa kuvendet e komunave, për çka është në papajtueshmëri me Kushtetutën dhe në kundërshtim me ligj. Për shkak rregullimit të tërësishëm e të drejtë të gjendjes faktike e juridike të lëndës, Ju lusim, në afat prej shtatë ditëve nga pranimiti i kësaj shkrese, të dorëzoni: a) vendimin e nënvizuar; b) sqarimin ndaj pohimeve të iniciativës.

SEKRETARI, I GJYQIT KUSHTETUES
Todor Kraleв

Rushit Ramabaja - çmimi Vjetor për Vepër Jetësore

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, sot në ora 13:30, bën ndarjen e Çmimit Kombëtar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" dhe për Çmimet Vjetore për Letërsi. Çmimi Vjetor për Vepër Jetësore do t'i ndahet shkrimtarit Rushit Ramabaja. Çmimi për prozë "Anton Pashku" shkrimtarit Fatmir Halimi për veprën "Dy vdekje e një jetë", Çmimi "Ali Podrimja" për veprën më të


mirë në poezi do t'u ndahet shkrimtarëve: Ismail Sylja për "Atdheun i ngrysur" dhe Ragip Sylja për veprën "Kam drojë për ty". Çmimin "Vehbi Kikaj" për fëmijë dhe të rinj do ta ndajnë shkrimtarët Mexhit Mehmeti "Ecejaket e Hero Lindit" respektivisht Avni Dehari "Flakadanë e Lirisë". Çmimi për veprën më të mirë në kritikë letrare dhe eseistikë "Ibrahim Rugova" i ndahet Arben Veselaj për studi-

min "Tema Kadareane", ndërkaq çmimi për veprën më të mirë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe anasjelltas "Pjetër Bogdani" i ndahet Orjela Stefanit për veprën "Njerëzit dhe ingranazhet".

Laureatët marrin çmimet respektive në bazë të vendimit të jurisë profesionale në përbërje të Hysen Matoshit, Merxhan Abdylit, Brikenë Ceraja-Beka, Shkelqim Millaku dhe Qazim Thaçi.



DEBATI PËR TEATRIN



Ndriçim Xhepa: Artistët të mos largohen pa u rrafshuar godina!

Ndërsa Teatri Kombëtar është përfshirë nga një valë tensioni, duket se aktori Ndriçim Xhepa ka qenë disi i veçuar nga takimet dhe mesazhet e forta publike. Por kjo, nuk do të thotë se nuk i interesojnë problemet që shqetësojnë kolegët e tij. Në një intervistë për gazetën "Panorama", aktori Ndriçim Xhepa jep mendimin e tij në lidhje me zhvendosjen e trupës së TK pranë qendrës së re kulturore "Turbina", por edhe për atë çka duhet bërë me godinën ekzistuese. Xhepa është kundër largimit të trupës nga godina ekszistuese, deri në momentin ku projekti i ndërimit të teatrit të ri të marrë udhë e të jetë në fazën finale.

Aktori është i mendimit që Shqipëria ka nevojë për një teatër të ri, në vendin ku sot ngrihen dy teatrot ai Kombëtar dhe ai Eksperimental. Po ashtu ai shpreh shqetësimin e vet në lidhje me projektligjin i cili parashikon futjen nën varësi të Ministrisë së Kulturës, së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë. Për Xhepën ai institucion ka 20 vjet që funksionon, edhe pse mund të bëhet edhe më shumë për rritjen e cilësisë së prodhimeve. Dhe këtë të fundit Mk mund ta përmirësojë përmes investimeve në specializimin e regjisorëve e skenaristëve të rinj.

"KALIMERA POETIKE" NDEROHET ME EMRIN E BASRI ÇAPRIQIT



Shoqata e Artistëve dhe Intelektualëve "Art Club" ka vendosur që manifestimi letrar "Kalimera Poetike", të cilin e organizon kjo shoqatë, në të ardhmen të mbajë emrin e poetit, studiuesit dhe pedagogut universitar prof. dr. Basri Çapriqi.

Vendimi është marrë në Kuvendin vjetor të Shoqatës për të nderuar këtë personalitet të letërsisë shqipe dhe studimeve albanologjike, i cili u nda nga jeta më 14 janar të këtij viti, bëhet me dije në njoftimin për media të shoqatës.

Basri Çapriqi ishte i lidhur shpirtërisht me vendlindjen e tij - Ulqinin. Ai do të bëhej urë bashkëpunimi ndërmjet krijuesve të Ulqinit

dhe krijuesve shqiptarë nga të gjitha trevat shqiptare, duke frymëzuar breza të tërë, sidomos të rinjtë, por edhe miqtë e tij në rrugën e dijes dhe kulturës, me fjalë dhe me vepra.

Çapriqi është njëri ndër themelesit dhe ideatorët e manifestimit letrar "Kalimera Poetike". Prandaj me këtë akt vlerësojmë kontributin shumëdimensional të Çapriqit për këtë manifestim dhe për SHAI "Art Club" në përgjithësi. Jemi të bindur se emërtimi i "Kalimerës Poetike" me emrin e Basri Çapriqit (Kalimera Poetike "Basri Çapriqi") nderon këtë manifestim dhe do të ndikojë në rritjen e mëtejshme të tij.

Ky është vetëm hapi i parë i

Shoqatës sonë, por në të ardhmen do të vazhdojmë që me nisma dhe aktivitete të ndryshme të nderojmë këtë figurë të shquar të letërsisë, arsimit dhe kulturës mbarëshqiptare.

"Kalimera Poetike" është manifestimi më i rëndësishëm letrar që mbahet ndër shqiptarët në Mal të Zi dhe njëra ndër veprimtaritë letrare më prestigjioze në hapësirën shqiptare dhe në rajon. Mysafirë të saj kanë qenë penat më të shquara të letërsisë shqipe dhe të letërsisë së vendeve të rajonit.

Basri Çapriqi u lind në Krythë të Anës së Malit (Ulqin) në vitin 1960, kurse vdiq në Prishtinë, në moshën 58-vjeçare.

Tre aktorë nga Kosova në "Berlinale"



Dëshmi për kinematografinë e potencialin e aktorëve kosovarë, në "Berlinale", do të dërgohen edhe nëpërmjet filmit holandez "Kiem Holijanda", që përfshin në kastë edhe aktorë kosovarë.

Arbnesha Grabovci-Nixha, Andi Bajgora e Florist Bajgora, do të jenë prezentë në shfaqjen e filmit në kuadër të kategorisë "Generation 14 plus". Filmi 14-minutësh, me një histori kosovare, e ka në kastë edhe aktoren Shpëtim Selmani.

Florist Bajgora, ka thënë se ai dhe vëllai i tij Andi, sikurse edhe aktorja Arbnesha Grabovci-Nixha, do të jenë prezentë në Berlin në premierën e filmit.

Filmi "Kiem Holijanda" është realizuar me regji e skenar të Sarah Veltmeyer dhe është produksion holandez i mbështetur nga Fondi Holandez i Filmit

Personat publik në rolin e përzgjedhësve të filmave

Kinoteka e Maqedonisë këtë muaj do ta vendosë ciklin filmik "Redaktor për një arsye", në të cilin do të shfaqen filmat e përzgjedhur nga ndonjë personalitet publik.

Redaktori i parë i filmave me përzgjedhje personale do të jetë Vllatko Stefanovski.

"Programi do të paraqet përzgjedhje të filmave, i cili e potencion aspektin personal të përje-

timit të një veprë filmike dhe çdo muaj një personalitet publik do të ketë mundësi dhe liri të jetë "redaktor filmik", kumtoi Kinoteka.

Me përzgjedhje të tij më 26 shkurt do të shfaqen filmi "Paris, Teksas" i Vim Uenders (1984), më 27 shkurt filmi maqedonas "Verë e qetë" i Dimitrie Osmanli (1961) dhe më 28 shkurt - "Bukuria e madhe" e regjisorit Paolo Sorrentino (2013).





Shenjat që tregojnë se jeni duke e tepruar me sheqer

Nuk është sekret se sheqeri gjendet në thuajse çdo gjë që e konsumoni, bile edhe në ato ushqime që fare se prisni.

Gjithashtu nuk është sekret se konsumimi i sheqerit është duke u bërë problem serioz që mund të shpijë në probleme shëndetësore si diabeti dhe sëmundjet e zëmrës. Duke e pasur këtë parasysh, është e rëndësishme që të kemi kujdes me sasinë e sheqerit që e konsumojmë. Por, si ta dini se jeni duke e tepruar me këtë substancë? Epo, shikoni këto shenja!

KENI NEVOJË PËR SHEQER... SHUMË SHEQER. Besojeni ose jo, faktikisht është e mundshme të vareni nga sheqeri. Dhe, sipas ekspertëve shëndetësorë, aq më shumë që hani sheqer, aq më shumë apetit zhvillon për të. Pra kur e gjeni veten duke dëshiruar vazhdimisht të hani diçka të ëmbël, mos e shmangni këtë dëshirë por shiheni si mundësi që dëshirat tuaja mund të jenë shenjë e një problemi më të madh.

KENI SHTUAR PESHË. Ndoshta e keni vërejtur se kohëve të fundit keni shtuar peshë por nuk po e dini arsyen përse. Arsyja për këtë mund të jetë se gjërat e ëmbla të cilat përmbajnë shumë sheqer nuk mjaftojnë për t'ju ngopur, prandaj edhe ju nxisin të hani më shumë. Simptoma tjera përfshijnë ndryshimin e disponimit, shëndetin e keq të lëkurës, mungesën e energjisë, etj.

GJUMI I PAMJAFTUESHËM TE FËMIJËT NDIKON PËR DIABETIN E TIPIT 2

Në një hulumtim të publikuar në ueb faqen e "Science Daily" thuhet se te fëmijët të cilët flenë më pak se koha e rekomanduar, ka më shumë gjasa që të shihen rastet e diabetit të tipit 2

Zbulohet se mungesa e gjumit te fëmijët, nga ajo që është e nevojshme ka ndërlidhje me diabetin e tipit 2. Në një hulumtim të publikuar në ueb faqen e "Science Daily" thuhet se te fëmijët të cilët flenë më pak se koha e rekomanduar, ka më shumë gjasa që të shihen rastet e diabetit të tipit 2, nivel të lartë të sheqerit të gjakut dhe rezistencë të insulinës. Hulumtuesit në Britani të Madhe kanë ekzaminuar statistikën vitale, gjakun të 4.525 fëmijëve të moshave 9-10 vjeçare, të cilëve iu rekomandohej të flenë mesatarisht 10 orë në ditë. Në hulumtim konstatohet se fëmijët të cilët flenë më shumë se mesatarja kanë peshë të trupit dhe



masë të yndyrës më të ulët, kurse ata që flenë më pak kanë nivel të lartë të insulinës, rezistencë të insulinës dhe sheqer të gjakut, të cilat janë faktorët e rrezikut të diabetit të tipit 2. Kryesuesi i hulumtimit nga Universiteti St. George në Londër, Prof. Christopher G. Owen njoftoi se rezultatet kanë treguar që me rritjen e kohës së kaluar në gjumë mund të ulet rreziku nga

diabeti i tipit 2 në periudhat e para të jetës. Owen thotë se rritja e orës së gjumit në fëmijëri, mund të ketë ndikime edhe në gjendjen shëndetësore në periudhat e rritjes. Në hulumtim theksohet se rritja e kohës së gjumit për gjysmë orë brenda javës, mund të ulë indeksin e masës së trupit për 0,1 kg/m² dhe rezistencën e insulinës për 0,5 për qind, dhe që ulja e këtyre masa-

ve mund të ketë ndikime afatgjate në uljen e rrezikut të diabetit të tipit 2 për periudhat e ardhshme të jetës. Në anën tjetër, në hulumtim thuhet se nuk është gjetur ndonjë ndërlidhje mes kohës së gjumit dhe rreziqeve kardiovaskulare, lipideve të gjakut dhe tensionit. Rezultatet e këtij hulumtimi do të publikohen në numrin e shtatorit të revistës "Pediatrics".

Fëmijët hiperaktivë mendojnë ndryshe

Fëmijët me çrregullim të koncentrimin dhe hiperaktivitetit (attention deficit hyperactivity disorder - ADHD) informatat vizuale i përpunojnë ndryshe në krahasim me fëmijët pa çrregullime, tregon hulumtimi i ri i shkencëtarëve amerikanë. Duke gjetur modele të ndryshme të aktivitetit në trurin e fëmijëve me ADHD, hulumtuesit shpresojnë që një ditë do të mund të bëjnë testin i cili do ta zbulojë çrregullimin shumë herët. Si i kanë zbuluar shkencëtarët aktivitetet e ndryshme të trurit te fëmijët me sindromën ADHD? Fëmijëve të moshës prej 9 deri 15 vjeçare me dhe pa këtë sindromë, hulumtuesit u kanë dhënë



një varg testesh në të cilat nga ata kërkohet që të mbajnë mend dhe njohin grupet e caktuara të num-

rave. Aktiviteti i tyre trunor është skanuar në atë moment, ndërsa incizimet kanë treguar që fëmijët hiperaktiv i përpunojnë informatat vizuale në tjetër mënyrë. Mostra e aktivitetit të tyre trunor është më e ndryshme se tek fëmijët që nuk kanë këtë çrregullim. Konkretisht, skaneri ka shënuar aktivitet të reduktuar të neuroneve në fushat e trurit përgjegjëse për perceptim vizual dhe memorien punuese. Shkencëtarët shpresojnë që ky hulumtim do të ndihmojë në zbulimin e hershëm të sindromës ADHD.

Varësia nga testet e shtatzënisë

Ta kuptoni se keni mbetur shtatzënë është një nga momentet më emocionuese në jetë, e në veçanti kur për një kohë të gjatë keni pritur të keni një bebe. Prandaj, nuk është befasi që shumë nëna në pritje bëjnë më shumë se një test të shtatzënisë për t'i konfirmuar lajmet e mira. Sipas hulumtimeve të reja nga ueb sajti i prindërve 'ChannelMum', gratë shtatzëna në Mbretërinë e Bashkuar

me shumë gjasë janë duke u bërë të varura nga testet e shtatzënisë përgjatë javëve të para të shtatzënisë së tyre. Duke e quajtur këtë fenomen si 'varësia nga testi i shtatzënisë', sajti thotë se 62 për qind e nënave në pritje pranojnë se herë pas here bëjnë teste të tilla edhe pasi i kanë pranuar rezultatet pozitive – ku një në 12 gra e bëjnë këtë deri të vjen koha e skanimit 12-javor. Por, cila është ar-

syja për këtë? Gratë duan ta sigurojnë vetveten se çdo gjë është duke shkuar në rregull me shtatzëninë e tyre gjatë javëve të hershme kritike. Dhe, përderisa nuk ka asgjë të gabuar rreth kësaj, kostoja e testeve të përsëritura mund të jetë pak e lartë. Ekspertët sugjerojnë të mos bëheni e varur nga këto teste, sepse janë të shtrenjta dhe është i panevojshëm testimi i vazhdueshëm.



"Nuk dua të tingëllojë si alibi për mungesën e fitores, por ne bëmë më të mirën dhe mendoj se vetëm mungesa e fatit sportiv bëri mos të fitojmë. Mjafton të shihni përmbledhjen e shanseve dhe gjithçka është e qartë", thotë Ibrahim

BESART IBRAIMI FLET PAS NDESHJES ME VARDARIN



MUNGESA E FATIT SPORTIV BËRI QË MOS TË FITOJMË

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 15 shkurt - Skuadra e Shkëndijës nga Tetova nuk shfrytëzoi dot faktorin fushë për të vendosur ndoshta përfundimisht garën për titullin kampion në Maqedonisë. Kuqezinjtë e nisën me një barazim 1-1 sezonin pranveror pasi në stadiumin e qytetit në Tetovë u ndalën nga rivalët e Vardarit, duke prishur një ecuri prej gjashtë fitorësh radhazi në kampionat. Megjithatë edhe barazimi mund të konsiderohet një rezultat pozitiv për djemtë e trajnerit Qatip Osmani, të cilët ruajtën epërsinë prej tetë pikësh ndaj Vardarit edhe pas javës së 19-të. Cekim të parët në epërsi erdhën mysafirët me golin e Gërçarov, ndërsa sulmuesi Besart Ibrahim në minutën e 86-të barazoi rezultatin në 1-1, ndërsa i njëjti futbollist kishte edhe një mundësi ideale në minutën e 89-të, kur nuk arriti të shënojë nga një pozitive ideale. Ndryshe, Ibrahim për gazetën KOHA, thotë se ndeshja ka qenë e bukur, por pranon se i vjen keq që nuk kanë arritur ti gëzojnë tifozët me fitore. "Ndeshje e bukur që na len përshtypje shumë poziti-

ve në aspekt të ambientit të bukur të krijuar nga publiku dhe mbështetjes së madhe që kishim nga tribunat. Normal na vjen keq që nuk mundëm ti gëzojmë me fitore, por në anë tjetër reagimi i tyre pas ndeshjes na bën të besojmë se mbetën të kënaqur me lojën tonë dhe se fati nuk ishte me ne kësaj here", thotë për KOHA, Ibrahim. Ai pranon se fati në këtë përballje derbi nuk ka qenë në anën e tyre. "Nuk dua të tingëllojë si alibi për mungesën e fitores, por ne bëmë më të mirën dhe mendoj se vetëm mungesa e fatit sportiv bëri mos të fitojmë. Mjafton të shihni përmbledhjen e shanseve dhe gjithçka



Po realisht mendoj se tetë pikë janë përparësi e mirë që na vendos në pozitë ideale pasi gjithçka është në anën tonë. Nëse ne do të jemi në nivelin tonë, besoj se nuk do të kemi problem të ruajmë vendin e parë

është e qartë", shtoi më tej sulmuesi kërçovar. Në fund Ibrahim tha se tetë pikë epërsi janë një përparësi e mirë. "Po realisht mendoj se tetë

pikë janë përparësi e mirë që na vendos në pozitë ideale pasi gjithçka është në anën tonë. Nëse ne do të jemi në nivelin tonë, besoj se nuk do të kemi problem të ruajmë vendin e parë", përfundoi Besart Ibrahim, goledori i kuqezinjtë nga Tetova. Ndërkohë, futbollistët nuk do të kenë shumë kohë për pushim, pasi të dielën ata i pret një përballje tjetër e vështirë, ku në stadiumin "Boris Trajkovski" në lagjen Maxhari, do të jenë mysafir i FC Shkupi, skuadër kjo e cila në javën e parë të sezonit pranveror, demoloj skuadrën e Akademija Pandev me rezultatin e thellë 5-2.

Hat-trikun ua dedikoj "Shvercerave"

Shkup, 15 shkurt - Bazhe Ilijoskit nuk iu desh shumë që ti dëshmojë vlerat e tij, tanimë në fanelën e FC Shkupi, ku u transferua gjatë afatit kalimtar të janarit. Numri 18-të i skuadrës nga Çairi, kishte një super-debutim në ndeshjen e parë të sezonit pranveror, kundër Akademija Pandevit. Në fakt për vetëm 16-të minuta, Ilijoski shënoi hat-trik, derisa kishte mundësi të shënojë edhe një, poqëse do të kishte realizuar penaltinë. Derisa pas këtij hat-triku, Ilijoski tha se atë ua dedikon grupit të tifozëve "Shvercerat Shkup". "Jam shumë i kënaqur që arritëm fitore të thellë. Sigurisht se jam i kënaqur edhe për tre golat e mi në paraqitjen time të parë zyrtare në fanelën e FC Shkupi. Këtë hat-trik ua dedikoj 'Shvercerave', tifozëve të Shkupit, të cilët më dhanë gjithë mbështetjen në debutimin tim të parë", tha për "Makedonski Sport", Ilijoski, i cili pas këtij hat-triku, Ilijoski arriti në kuotën e 133 golave në kampionatin vendor. Ndërkohë, nga dita e djeshme skuadra e FC Shkupi është kompletuar, pasi që në stërvitje janë paraqitur edhe përforcimet e fundit, si Toni Tipuriç, Emre Xhan Atila dhe ardhja e fundit, futbollisti 20 vjeçar, Valentin Kocoski, i cili vjen nga skuadra e Horizont Turnovës.



RENDITJA E FIFA-S, MAQEDONIA BIE NJË POZITË

Shqipëria e Kosova ngjiten një vend më lartë

Shkup, 15 shkurt - FIFA ka publikuar dje renditjen mujore të kombëtareve. Për shkurtin, kuqezinjtë e trajnerit Kristian Panuçit kanë ngjitur një vend në krahasim me pozicionin e muajit

të kaluar, edhe pse nuk kanë luajtur ndonjë ndeshje zyrtare në këtë kohë. Më konkretisht, Shqipëria renditet në vendin e 59-të, me 553 pikë në total. Nga ana tjetër, edhe Kosova ka fituar një

pozicion dhe tashmë ngjitet në vendin e 177-të në renditjen e përgjithshme, me 97 pikë. Derisa, përfaqësuesja e Maqedonisë ka pësuar rrënje prej një pozite dhe tani gjendet në pozitën e 74.

Ndërkohë, dhjetëshja e parë përbëhet nga Gjermania si liderë, ndërsa atë e ndjekin, Brazili, Portugalia, Argjentina, Belgjika, Spanja, Polonia, Zvicra, Franca dhe Çile.

LËSHOHET NË PËRDORIM OBJEKTI I RI AKOMODIMIT I FFM-SË

Çeferin: Shfrytëzoheni Ligën e kombeve për tu plasuar në Evropian

Shkup, 15 shkurt - Ashtu siç paralajmëroi, Aleksandar Čeferin, i pari i UEFA-së, mori pjesë në hapjen e objektit të ri të FFM-së. Në praninë edhe të kryetarit të FFM-së, Ilco Gjorgjioski si dhe zëvendëskryeministrit të Maqedonisë, Koço Angjushev, ata lëshuan në përdorim objektin e ri i cili do të shërbejë për akademinë dhe për ekipet e grupmoshave të reja të Maqedonisë. "I thashë edhe Gjorgjioskit, se nuk ka më alibi. Keni rast të mirë që nëpërmjet Ligës së kombeve të plasoheni në



Kampionatin Evropian dhe këtë duhet ta shfrytëzoni", theksoi Čeferin.

"Po që se ju definojnë nga veprat dhe jo nga fjalët, kjo do të

thotë se ju keni arritur sukses. Sot është ditë e madhe për futbollin e Maqedonisë.

Kur para tre viteve FFM hyri në programin e ri zhvillimor të UEFA-së, shumë qartë i prezantua ideat tona për zhvillimin e futbollistëve të rinj. Më shumë kujdes i kushtuam Akademisë, ajo të jetë shkollë e së ardhmes me të vetmin qëllim që të përgatisim futbollistët e rinj", deklaroi Gjorgjioski, kryetar i FFM-së. "Pajtohem me atë që e tha Čeferin, Pasi janë krijuar kushtet, nuk ka hapësirë

për rezultate të dobëta. Futbollistëve të rinj ju dëshiroj shumë momente të bukura në këto hapësira të bukura dhe fat e suksese në karrierë", tha numri dy i qeverisë së vendit Angjushev. Ndërkohë, në mesin e të pranishmëve ishte edhe drejtori teknik i FIFA-së, Marko Van Basten, i cili vizitoi anëtarët e Akademisë së futbollit të FFM-së dhe UEFA-së. Po ashtu prezent ishin anëtarët e KD të FFM-së, si edhe shumë ish-trajner që kanë punuar në ekipet përfaqësuese të Maqedonisë.

ROUSEJ MË 25 SHKURT DEBUTON NË "WWE"



Ronda Rousej do të nisë karrierën e saj në "World Wrestling Entertainment" më datën 25 shkurt, ku do të jetë e pranishme në "T-Mobile Arena" të Las Vegasit në evenimentin "Elimination Chamber". Ikona e UFC-së rikthehet në stadiumin ku ka dueluar për herë të fundit në karrierën e saj, më 30 dhjetor 2016, ku u mund me "ko teknik" nga Amanda Nunes. Por tashmë Rousej rikthehet në këtë stadium në një disiplinë tjetër sportive, në kërkim të suksesit në një sport të ri, atë të "WWE"-së. Ende nuk dihet nëse Rousej do të duelojë në atë eveniment apo vetëm do të nënshkruajë kontratën me "WWE"-në. Mediat amerikane shprehën se nënshkrimi i kontratës me drejtuesit e "WWE"-së është pjesë e atij spektakli që do të organizohet në Las

Ikona e UFC-së rikthehet në stadiumin ku ka dueluar për herë të fundit në karrierën e saj, më 30 dhjetor 2016, ku u mund me "ko teknik" nga Amanda Nunes. Por tashmë Rousej rikthehet në këtë stadium në një disiplinë tjetër sportive, në kërkim të suksesit në një sport të ri, atë të "WWE"-së

Vegas, një eveniment që do të jetë me pagesë (PPV-pay per view). Rousej u paraqit muajin e kaluar edhe në evenimentin e "Royal Rumble", ku dhe konfirmoi kalimin e saj në "World Wrestling Entertainment", por tashmë ka ardhur koha që ajo të zhvillojë sfidën e parë. "Tashmë kjo është shtëpia ime e re, do të nis një karrierë të re në këtë disiplinë sportive. Kur jam takuar me drejtuesit e këtij sporti u kam thënë se do të dueloj këtu një ditë. Unë nuk e bëj këtë gjë për para apo për publicitet, por sepse më pëlqen shumë ky sport", tha Rousej, një nga ikonat e arteve marciale mikse, por tashmë gati për të nisur një aventurë të re në jetën e saj. Kështu, 25 shkurti do të jetë dita e madhe e debutimit të Ronda Rousej në "WWE".

Publicitet

Në bazë të nenit 64 paragrafi 3 alineja 7 të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/08...), dhe Vendimit nga Dekani të Fakultetit për siguri nr. 04-152/1 të datës 14.02.2018, Dekani i Fakultetit për siguri – Shkup, njëjta në kuadër të Universitetit "Shën Kliment Ohridski" – Manastir publikon

KONKURS

Për zgjedhje të:
Mësimdhënësit

- një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën shkencore Bazat e shkencës së policisë (51609);

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Statutin e Universitetit "Shën Kliment Ohridski" – Manastir dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Shën Kliment Ohridski" – Manastir dhe akteve të përgjithshme të Fakultetit.

Fillimi, mbarimi dhe orari i punës dhe shume e të hollave e pagës bazë (në shumë bruto: 56.429,00 denarë) për mësimdhënësin janë të ndryshueshme dhe përcaktohen në pajtim me aktet e Fakultetit sipas orarit të mësimit në semestër, angazhimit dhe titullit në të cilin është zgjedhur mësimdhënësi.

Fletëparaqitjet të dorëzohen në Arkivin e Fakultetit për siguri, rr. "1" Kolonia Idrizovë nr. 2A, Shkup, me shenjë "Për konkurs".

Së bashku me fletëparaqitjet kandidatët duhet të dorëzojnë: biografi të shkurtë (në tri kopje), dokumente për arsim të mbaruar në original ose kopje të vërtetuara në noter, certifikatë të shtetësisë, listë të punimeve shkencore ose profesionale dhe nga një kopje të punimeve të publikuara veças ose në publikim, dhe formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titullin mësimor-shkencor, mësimor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues (Buletini i Universitetit nr. 382 të datës 31.12.2013) dhe vlerësim pozitiv për vetevalium.

Konkursi zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

FAKULTETI PËR SIGURI – SHKUP

REPUBLIKA E MAQEDONISË
UNIVERSITETI "SHËN.KIRILI DHE
METODI" - SHKUP
FAKULTETI PËR MJEKËSI
VETERINARE SHKUP



REPUBLIC OF MACEDONIA
UNIVERSITY "Ss. CYRIL AND METHODIUS" SKOPJE
FACULTY OF VETERINARY MEDICINE
SKOPJE

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/08, 103/08, 26/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 57/13, 41/14, 116/14, 130/10/2015, 20/2015, 154/15, 30/16, 120/16, 127/16), nenit 34 paragrafi 2 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup – teksti i pastruar (Lajmëtarit universitar nr. 274 të datës 31 dhjetor 2013) dhe Vendimeve të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit për mjekësi veterinare – Shkup nr. 0202 – 182/5, 0202 – 182/6 dhe 0202 – 182/7 të datës 9.02.2018 dhe nenit 48 të Rregullores për marrëdhënie të brendshme dhe punën e Fakultetit të mjekësisë veterinare në Shkup në përberje të UKIM – teksti i pastruar (Lajmëtarit universitar nr. 361 të datës 3 prill 2017), dekani i Fakultetit për mjekësi veterinare në Shkup shpall

KONKURS

Për zgjedhje në titujt shkencor

1. Një hulumtues në të gjitha titujt shkencor në sferën mësimor-shkencore 40723 – Andrologjia dhe pllenimi artificial
2. Një hulumtues në të gjitha titujt shkencor në sferën mësimor-shkencore 40725 – Terapija dhe mbrojtja shëndetësore e kafshëve
3. Një hulumtues në të gjitha titujt shkencor në sferën mësimor-shkencore 40711 – Sëmundjet e kafshëve jo përtypëse.

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet e Fakultetit për mjekësi veterinare në Shkup.

Së bashku me fletëparaqitjet duhet të dorëzohen edhe dokumentet në vijim: biografi e shkurtër, dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe posaçme, certifikatë të shtetësisë, listë të punimeve shkencore dhe profesionale dhe nga një kopje për secilin punim në formë elektronike. Dëshmitë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme dorëzohen në original ose kopje të vërtetuara në noter. Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënësit është i caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet të dorëzohen në ndërtesën e Fakultetit për mjekësi veterinare në Shkup, rr. "Lazar Pop Trajkov" nr. 5-7, tel. 02 3240 700.

Dokumentet e pakompletuara dhe dokumentet e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në procedurë të shqyrtimit.

REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E STRUGËS
Nr. 10-2442/2017
12.02.2018
Strugë

Në bazë të nenit 69 të Ligjit për mjedisin jetësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16 dhe 42/16) dhe urdhëresën për pjesëmarrjen opinionit gjatë përpilimit të dispozitave dhe akteve tjera, si dhe planet dhe programet në sferën e mjedisit jetësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 147/08 dhe 45/11), Kryetari i Komunës së Strugës

ORGANIZON

Shqyrtim publik dhe konsultim me opinionin sipas Raportit për vlerësim strategjik në ndikim të mjedisit jetësor për përpunimin e dokumentacionit të Planit urbanistik lokal (DPLU) për projektin G2 – industri e lehtë dhe G4 – shkarkim në repartin prodhues magazinë në PK 2397, KK Misleshovë, Komuna e Strugës.

1. Informohet opinionin se është vënë në shqyrtim dhe konsultim me opinionin, Raportit për vlerësim strategjik në ndikim të mjedisit jetësor për (DPLU) për projektin G2 – industri e lehtë dhe G4 – shkarkim në repartin prodhues magazinë në PK 2397, KK Misleshovë, Komuna e Strugës.
2. Raporti për vlerësimin strategjik në ndikim të mjedisit jetësor është ekspozuar në Sektorin për urbanizëm, veprimtari komunale, komunikacion dhe mbrojtje të mjedisit jetësor, në Komunën e Strugës çdo ditë pune nga ora 8-16, filluar nga data 13.02.2018 deri më 14.03.2018.
3. Konsultimi me opinionin do të mbahet në 09.03.2018 në Komunën e Strugës, me fillim në orën 14.30.
4. Personat juridik dhe fizik dhe opinionin mund të parashtrorin mendimet e tyre në lidhje me Raportin deri te Komuna e Strugës në afat prej 30 ditëve në shqyrtim publik.
5. Të gjitha palët e interesuara janë të ftuara të marrin pjesë në debatin publik dhe të japin mendimet e tyre, vërejtjet dhe propozimet sipas Raportit për vlerësim strategjik në ndikimin e mjedisit jetësor dhe të njëjtat mund t'i dërgojnë në e-mail: info@struga.gov.mk ose përmes postës në adresën: Komuna e Strugës, rr. Nënë Tereza pn, 6330 Strugë.

KOMUNA E STRUGËS
Kryetar
Dr. Ramis Merko

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune të Gazetës zyrtare të RM 1 67/20 15, neni 77, 79, 80 dhe 82 nga Ligji për arsimin fillor (Gazetës zyrtare të RM numër 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14 dhe 135/14)

Drejtori i SHFK "Kirili dhe Metodij" fsh. Rramanli Kumanovë shpallë

Konkurs

Për punësim një pastrues për në ShFP Agino Selo mirëmbajtës i higjienës me kohë të pacaktuar

1. Një pastrues për në ShFP Agino Selo me pagë mujore 11,534 den.

Koha punë me 40 orë në ditë. Dokumentet e kompletuara dhe që kanë të mbaruar arsimin përkatës në bazë të ligjit për arsimin fillor.

Konkursi do të jetë i shpallur 5 ditë pune prej ditës së shpalljes ne SHFK "Kirili dhe Metodij" Fsh.

Rramanli, e-mail adresa: kiril.metodij@mail.net.mk

Drejtori: Selver Shabani

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 62/2005), nenit 80 dhe nenit 82, paragrafi 1, paragrafi 3 dhe paragrafi 4 i Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 103/2008...10/15), pas marrjes së Pëlqimit për financim të vjetër nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë nr. 12-1270/5, Shkolla fillore komunale "Josip Broz Tito" Vallandovë, publikon:

SHPALLJE

Për plotësimin e vendit të punës për kohë të pacaktuar të punës

1. Mirëmbajtës të higjienës me 40 orë pune (orar i plotë i punës) – 1 (një) realizues

Orari i punës për mirëmbajtësin e higjienës është me ndërrime, ndërrimi i parë fillon në ora 06:00, dhe zgjatë deri në ora 14:00, ndërsa ndërrimi i dytë fillon në ora 12:00 dhe zgjatë deri në ora 20:00. Neto pagesa mujore është 12.000,00 denarë + shtesa e punës së kaluar në shumë prej 0,5% për secilin vit të stazhit të punës për orar të plotë të punës;

Kandidatët duhet të parashtrorin:

- Fletëparaqitje, të shkruar dhe të nënshkruar me dorë;
- Dëftesë ose diplomë për arsimin fillor ose të mesëm të mbaruar (original ose kopje të vërtetuara në noter);
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë;
- Vërtetim se nuk është i dënuar

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit. Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të parashtruar pas afatit nuk do të merren parasysh. Fletëparaqitjet dhe dokumentet e nevojshme duhet të parashtrorin personalisht në arkivin e Shkollës fillore komunale "Josip Broz Tito" Vallandovë, në rrugën "6-ti Noemvri" pn, Vallandovë.

SHFK "Josip Broz Tito" Vallandovë, Drejtor: Daniella Xhonova

I nr. 1823/2017

SHPALLJE PUBLIKE

(në bazë të nenit 48 paragrafi 2 i Ligjit për përbarim Gazeta Zyrtare nr. 72 e datës 12.04.2016)

Përbaruesi Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përbarimit nga kreditori Univerzalna Investiciona Banka SHA Shkup nga Shkupi me seli në rr. Maksim Gorki nr. 6, bazuar në dokumentin përbarues ODU nr. 1747/13, ODU nr. 1748/13 të datës 15.11.2013 të Noter Sebaedin Dauti – Gostivar, kundër borxhlinjve 1. Xhezmi Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë 2. Gjuzazije Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, 3. Fatime Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë dhe borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai nga Gostivari me seli në rr. Nikolla Parapunov nr. 236, për realizim të përbarimit në vlerë prej 12.064.787,00 den., më datë 12.02.2018:

FTON

Borxhlinjtë Xhezmi Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, Gjuzazije Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, Fatime Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë dhe borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai nga Gostivari me seli në rr. Nikolla Parapunov nr. 236 për shkak të dorëzimit të:

Konkluzionit për shtyrje të përbarimit në bazë të nenit 91 paragrafi (1) të LP l. nr. 1823/2017 të datës 15.01.2018 të Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në mjetet e informimit. PARALAJMËROHEN borxhlinjtë Xhezmi Emro, Gjuzazije Emro, Fatime Emro dhe borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai, se mënyra e këtillë e parashtrimit konsiderohet si e dorëzimit i rregullt dhe se pasojat negative që mund të dalin i bartë vet pala.

KJO PARAQET SHPALLJEN E DYTË.

Përbarues
Aleksandar Kuzmanovski

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – tekst i pastruar (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015) dhe lajmërimit për pëlqim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nr. 12-1033/1 të datës 29.01.2018, publikohet

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të nikoqirit – ekonomit – 1 realizues, për kohë të pacaktuar të punës, për 40 orë pune në javë, prej ora 8-16 (prej ditës së hënë deri ditën e premte), neto pagesa mujore 15.000 den. Së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrorin: Certifikata e shtetësisë së RM dhe dëftesa për arsimin e mesëm të mbaruar. Dokumentet duhet të jenë në original ose kopje të vërtetuara a në noter. Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit. Zgjedhja do të realizohet në afat në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.

SHFK "Mirçe Acev – Shkup, rr. Meçkin Kamen nr. 26, tel. 02/2041-509, personi për kontakt Matovska Petra

“Është gjithmonë e veçantë kur ti shënon dhe ekipi fiton ndeshjen. Kam qenë më i miri në fushë në këtë ndeshje, kam ndihmuar skuadrën të fitojë duke shënuar dy gola”, tha portugezi pas ndeshjes

Real Madrid ka hedhur një hap të rëndësishëm drejt çerekfinaleve të Ligës së kampionëve pasi ka mundur 3-1 Paris Sen-Zhermenin mbremjen e së mërkurës në “Bernabeu”. Francezët kanë kaluar në avantazh me Rabio, por kampionët në fuqi të Evropës kanë përmbysur rezultatin me golat e Ronaldos dhe Marselos. Kur jemi te Ronaldo duhet përmendur se ai ndaj Parisit shënoi golin e 100-të në Ligën e kampionëve, më shumë se çdokush tjetër. “Është gjithmonë e veçantë kur ti shënon dhe ekipi fiton ndeshjen. Kam qenë më i miri në fushë në këtë ndeshje, kam ndihmuar skuadrën të fitojë duke shënuar dy gola”, tha portugezi pas ndeshjes. Pavarësisht avantazhit të dy golave, Ronaldo nuk beson se kualifikimi është i sigurt. “Asgjë nuk ka mbaruar akoma. Duhet të shkojmë në Paris të provojmë të fitojmë dhe të sigurojmë kualifikimin”, deklaroi portugezi. Ndryshe, pas ndeshjes ka folur edhe kapiteni i Realit Sergio Ramos. Ai ka theksuar punën e mirë të ekipit dhe i dërgoi një mesazh Evropës. “Real Madridin nuk mund ta merrni kurrë për të vdekur. Fitorja është një sukses i rëndësishëm dhe premtues për kthimin. Sidoqoftë, duhet të përgatitemi me seriozitet dhe të mbrojmë kurorën e kampionëve në Evropë. Çdo gabim

REALI ME DY GOLAT E RONALDOS DHE MARSELOS MUNDI PSZH-NË

ISHA MË I MIRI KUNDËR PARISIT



Sergio Ramos

Real Madridin nuk mund ta merrni kurrë për të vdekur. Fitorja është një sukses i rëndësishëm dhe premtues për kthimin. Sidoqoftë, duhet të përgatitemi me seriozitet dhe të mbrojmë kurorën e kampionëve në Evropë.

në këtë kompeticion mund të të lërë jashtë. Në Paris duhet të ruajmë përqendrimin maksimal. Ne kemi hedhur një hap të rëndësishëm, por kualifikimi është i hapur. Ne duhet të vazhdojmë të punojmë”, tha Ramos.

NEJMAR: NUK KEMI PJEKURI, DUHET TA PRANOJMË KËTË

Braziliani Neymar tha pas humbjes 3-1 të PSZH-së në “Bernabeu”, kundër Real Madridit, se “asgjë nuk është vendosur”, dhe se kualifikimi do të zgjidhet në Paris, ku ai shpreson për të përmbysur gjithçka. Neymar u shfaq disa sekonda në zonën e përzier, para mediave, me një fytyrë shumë serioze dhe pa dëshirë për të folur. Asgjë nuk është vendosur, është edhe ndeshja e dytë”, – tha ai. Lojtari i PSZH-së beson në përmbys-

sjen. “Unë mendoj se ne mëkatojmë në kohë, nuk treguam qetësi dhe maturi për të luajtur në gjysmën e dytë të pjesës së dytë. Skuadra nuk kishte ndonjë gjë tjetër dhe duhej ta pranonte atë. Nuk luajtëm një lojë të keqe, por duhet të përmirësohemi, nëse duam të kthehemi. Është e vështirë, por nuk është e pamundur. Vitin e kaluar kishim një situatë më të vështirë për të kaluar”, u shpreh Neymar. Derisa, Pas takimit ka folur trajneri i skuadrës franceze, Unai Emeryt, i cili tërthorazi ka akuzuar gjyqtarët se kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar. “Shpjegimi është i thjeshtë, ne duhet të marrim parasysh 90 minutat e lojës. Ekipi ynë ka luajtur një lojë fantastike, por edhe pse rezultati nuk është i mirë, ne luajtëm me personalitet. Por me dy qëllimet e

tyre të fundit ishte e vështirë. Ndoshta çdo gjë është e vendosur nga detajet e vogla, gjyqtari nuk na ka ndihmuar, por ishte e qartë se na ka dëmtuar. Prej fillimit ishte më i afërt me Real Madridin, por për mua nuk ishte penalti në rastin e Kroosit. Ai përdori kriteret e ndryshme sa i përket te Ramosi”, tha spanjollli.

LIVERPULI ME NJË KËMBË NË ÇEREKFINALE

Liverpuli prek me një dorë çerekfinalen e “Champions League”, pasi ka fituar 5-0 në “Dragao” ndaj Portos, një rezultat që e bën ndeshjen e kthimit në “Anfield Road” thjesht një formalitet për ekipin e drejtuar nga Jurgen Klopp. Mane shënoi hat-trik për ekipin anglez, ndërsa nga një gol shënuan Sallah dhe Firmino. Ndryshe,

për Sallah ky ishte goli i 30-të për Liverpuln në të gjitha veprimtaritë, vetëm një gol larg rekordit të Luis Suarez me 31 gola në sezonin 2013/14. Ndryshe, trajneri i Liverpulit, Jurgen Klopp lavdëroi ekipin e tij pas paraqitje fantastike në fitoren 05: në udhëtim te Porto dhe insiston se rezultati erdhi pas një punë të madhe. “Mbrojtje e mirë, kundërsulme të mira, mbajta e topit dhe qarkullimi i tij. Nuk ishte e lehtë sonte (e mërkurë), ishte një punë e madhe dhe në fund djelmoshat e shijuan frytin e punës dhe kjo është gjëja më e rëndësishme. Golat ishin të gjithë fantastik. Goli i parë, kur Dejan (Lovren) e fitoi topin dhe Sadio e goditi në fund, goli i dytë ishte një finalizim i mirë nga Mo dhe i treti ishte nga një lojë fantastike në kundërsulm. Ishin të gjithë fantastikë dhe kishim nevojë për to”, deklaroi Klopp.

De Brune është futbollisti më i mirë në Premier



Kevin De Brune është futbollisti më i mirë në Premier Ligë për momentin. Ky është mendimi i shokut të tij te kombëtarja e Belgjikës, futbollisti i Çellsit, Eden Hazard. Mesfushori i Mançester Sityt po shkëlqen në drejtimin e Guardiolas, ashtu si e gjithë skuadra që kryeson kampionatin me 16 pikë avantazh ndaj Mançester Junajtedit. De Brune ka shënuar shtatë gola dhe ka dhënë 14 asistime në 27 ndeshje të luajtura me Sityt në të gjitha veprimtaritë. De Brune u shit nga Çelisi te Wolfsburgu për 25 milionë

euro, në janar 2014, pasi nuk arriti të gjejë një vend në formacion, por Hazard mendon se aktualisht ai po shkëlqen në skemat e Guardiolas. “Kevin për momentin është futbollisti më i mirë në Premier Ligë dhe nuk kam asnjë dyshim për këtë. Momentalisht, Siti është skuadra më e mirë dhe De Brune është shumë i rëndësishëm për sistemin e lojës së aplikuar nga Guardiola. Personalisht e kam kënaqësi të luaj me Kevin, sepse është një futbollist i jashtëzakonshëm”, deklaroi Hazard.

Juventus pas Paredesit

Juventus është vënë pas mesfushorit të Zenit St.Petersburgut, Leandro Paredes, por duhet të përballë me konkurrencën e Real Madridit. Mesfushori argjentinas u bashkua me gjigantin rus nga Roma në këtë verë, ku ka shënuar katër gola dhe ka dhënë po as asistime. “Bianconerët” janë interesuar për të edhe sa ishte në Itali, por sipas Calciomercato.com, interesimi vazhdon. Zenit e vlerëson lojtarin diku rreth 40 milionë euro, por duhet të kihet parasysh edhe

konkurrenca nga Real Madridi, që është gati të paguajë 35 milionë euro dhe Mateo Kovaçiqin. Por, Kovaçiq nuk dëshiron që të kalojë në Rusi dhe kjo e bën Juventusin si favorit në ‘luftë’ me Realin. Paredes ka luajtur më parë në Itali për klube si Kievo dhe Empoli dhe kthimi në Serie A do t’i përshtatej atij. Argjentinas po lufton edhe për një vend në Kombëtaren e tij për Kupën e Botës, që mbahet pikërisht në Rusi ku ai po vazhdon karrierën.



Ndihem mirë në Paris

Transferimi te Barcelona, të paktën në të ardhmen e afërt nuk është në planet e Marko Verrattit. Italiani i Paris Sen-Zhermen s’e mendon veten me fanellën e klubit katalanas, kjo pasi për momentin ndihet shumë mirë në “Parc des Princes”. Mesfushori 25-vjeçar beson shumë te projekti i parisienëve dhe dëshiron të qëndrojë për një kohë të gjatë në Paris. Gjithsesi në të ardhmen e largët, Verratti nuk e përjashton mundësinë e firmës me Barcelonën.

SIPAS ISH-LEGJENDËS SË LIVERPULIT, STIVEN XHERRARD

"Emre Xhan po largohet dhe është e qartë se Keita po vjen", tha ish-kapiteni i Liverpoolit. Ka kohë që raportohet se mesfushori që e përfaqëson Gjermaninë ka arritur marrëveshje bazë për të kaluar te "Zonja e Vjetër" në verën e ardhshme, duke qenë se atij i përfundon kontrata me "Redsat" në fund të këtij sezoni

XHAN KA ARRITUR MARRËVESHJE ME "ZONJËN E VJETËR"

Legjenda e Liverpoolit, Stiven Xherrard, i ka forcuar akoma spekulimet se Emre Xhan do t'i bashkohet Juventusit. Ka kohë që raportohet se mesfushori që e përfaqëson Gjermaninë ka arritur marrëveshje bazë për të kaluar te "Zonja e Vjetër" në verën e ardhshme, duke qenë se atij i përfundon kontrata me "Redsat" në fund të këtij sezoni. Xhan nuk luajti kundër Portos për shkak të suspendimit, ndërsa ish-mesfushori anglez që tash ishte i angazhuar si ekspert nga "BT Sport", ka folur rreth opsioneve të Jurgen Kloppit në mesfushë. Strategu gjerman vendosi të luante në mesfushë me Henderson, Xhejms Milner dhe Vijnaldum, ndërsa Gerrard ka thënë se Liverpooli duhet të mësohet të luajë pa 24-vjeçarin. Kur është pyetur se a do të mund të luajë Hendersoni

pas transferimit të Naby Keitas nga RB Laipzig, legjenda e "Të Kuqve" tha: "Duhet të shohim çfarë do të ndodhë, sepse Emre Xhan po largohet dhe është e qartë se Keita po vjen", tha ish-kapiteni i Liverpoolit. Xherrard mendon se Henderson luan futbollin më të mirë në një pozitë më të avancuar dhe beson se Xhan është përshtatur më shumë të luajë në pozitën e mesfushorit defensivë. Liverpooli ka arritur marrëveshje me RB Laipzigun për transferimin e Keitas për 52 milionë funte (58.5 milionë euro) dhe ai do të luajë në "Anfield" nga korriku i këtij viti.



Bajerni do ta blejë Rodriguezin në verë

Hames Rodriguez është bërë një pjesë thelbësore në skemën e Jupp Heynkes, për shkak të multifunksionimit të tij, sigurisë për të dhënë topin dhe aftësisë në fazën mbrojtëse. Për këto arsye, "Sport Bild" i Gjermanisë pohon se Bayern Muni është i kënaqur me performancën e mesfushorit kolumbian dhe do të ushtrojë mundësinë për ta blerë në merkaton e ardhshme të verës (qershor), pasi Hames është aktualisht i huazuar nga Real Madrid deri në sezonin 2018-2019. Kur Hames arriti te Bajerni, verën e kaluar, ai pagoi pesë milionë euro për çdo sezon të transferimit dhe opsioni i blerjes është 35.2 milionë (përveç kësaj, ai do të kujdeset për pagën e lojtarit, rreth 8 milionë euro bruto). Nëse bavarezët e zbatojnë këtë klauzolë në vitin 2019, Real Madridi do të përfundojë duke rimbursuar 45.2 milionë euro për largimin e kolumbianit, që i kushtoi atij 80 milionë në vitin 2014. Hames, i cili është mesfushori më i mirë ofensivë në pesë ligat kryesore të Evropës, deri tani, këtë sezon, do të ketë sfidën e tij të ardhshme të shtunën, më 17 shkurt, kur Bajerni të vizitojë Wolfsburgun, në javën e 23-të të Bundesligës.



Publicitet

Përzgjedhje e re e modeleve SUV të Opel

SUV DOMINIM PËR TË GJITHË.

GRANDLAND X. CROSSLAND X. MOKKA X. Në dispozicion tek shitësit e Opel.



opel.mk

E ARDHMJA I
TAKON TË GJITHËVE

Pamja e shfaqur e veturës është vetëm për ilustrim dhe nuk ka të bëjë me këtë promovim. Opel Southeast Europe LLC dhe shitësit e autorizuar mbajnë të drejtën e tërheqjes së ofertës në çdo kohë dhe pa paralajmërim paraprak. Për më shumë informata kontaktoni shitësit e autorizuar të Opel. Oferta vlen deri më 31.03.2018.

Auto CEM 044 353 330

Automakedonija 02 310 31 30



Avokati i Trumpit pranon se ka paguar pornostaren


Michael Cohen, avokati për një kohë të gjatë i presidentit amerikan Donald Trump, pranoi se në vitin 2016, ka paguar privatisht me 130 mijë dollarë aktoren e filmave për të rritur, Stephanie Clifford. Përfaqësuesi ligjor i Trump rrëfeu se pagesa ndaj aktore Clifford, në periudhën kur Trump ishte kandidat për president, ka qenë e ligjshme dhe se bashkëpunëtorët e Trump apo pjesëtarë të fushatës së tij nuk ishin pjesë e këtij transaksioni. Unë e kam bërë privatisht dhe pa marrë asgjë në këmbim, tha avokati Cohen për NYT. Gjatë një interviste në vitin 2011, Stephanie Clifford ka thënë se

ka pasur një histori seksuale me Donald Trump gjatë vitit 2006, vetëm pak kohë pasi bashkëshortja e tij, Melania, kishte sjellë në jetë djalin Barron. Në muajin janar kjo intervistë u risoll në mediat amerikane, duke krijuar mjaft reagime, madje u përhap lajmi se avokatët e presidentit Trump kanë blerë heshtjen e aktore. Por avokati Cohen tha se Trump, e ka mohuar me forcë përfshirjen në një marrëdhënie me Clifford. E pyetur nga mediat, edhe aktorja e filmave për të rritur e ka ndryshuar deklaratën e saj, duke mohuar marrëdhënien me presidentin amerikan.

Thirrja e FBI dhe CIA: Mos i përdorni telefonat Huawei

Krerët e 6 agjencive më të mëdha të inteligjencës amerikane, mes tyre FBI, CIA dhe NSA, kanë paralajmëruar amerikanët që të mos përdorin produktet dhe shërbimet e gjigantëve kinezë të teknologji-

së, Huawei dhe ZTE. Sipas CNBC-së, shefat e inteligjencës e kanë bërë këtë rekomandim gjatë një dëgjese në Komitetin e Inteligjencës. Në fjalën e tij, drejtori i FBI-së, Chris Wray tha se qeveria ishte shumë e shqetësuar mbi rreziqet e lejimit të kompanive të huaja që të marrin pozicione të mira brenda rrjetit të telekomunikacionit. "Kjo do t'i lejojë atyre që të modifikojnë ose të vjedhin informacion. Gjithashtu, i lejon që të bëjnë spiunazh", shtoi Wray.



Në baltë zbulohet familje e re antibiotikësh

Shkencëtarët amerikanë kanë zbuluar një familje të re antibiotikësh në ekzemplarë të baltës. Komponentët natyral mund të përdoren për të luftuar infeksionet që janë të vështira për t'u trajtuar, ka bërë të ditur ekipi nga Universiteti Rockefeller. Testimet kanë treguar që komponenti i quajtur malacidins, ka asgjësuar disa sëmundje bakteriale që janë rezistente ndaj shumicës së antibiotikëve, duke përfshirë edhe superbakteren MRSA. Ekspertët besojnë se kjo punë, e publikuar në revistën Nature Microbiology, ofron shpresë për gjeneratën e re të antibiotikëve. Sëmundjet rezistente ndaj ilaçeve janë një nga kërcënimet më të mëdha shëndetësore globale.

Ndërrohet me vëllain e tij binjak, i riu i shpëton burgut për 13 muaj



Autoritetet në Peru kanë arrestuar për të dytën herë një të burgosur, pasi ai u arratis nga burgu duke lënë vëllain e tij binjak në vend të tij. Aleksandër Delgado ishte duke vuajtur një dënim 16-vjeçar pasi ishte akuzuar për abuzim seksual me të mitur dhe vjedhje. Kur binjaku i tij, Giancarlo, e vizitoi atë në janarin e kaluar, Aleksandri e drogoi, veshi rrobat e tij dhe doli nga burgu. Shkëmbimi i dyshuar u konfirmua, pasi u morën shenjat e gishtërinjve të Giancarlos. Pas 13 muajsh në arrati, Aleksandër Delgado u arrestua të hënën në qytetin port të Callao, pasi Ministria e Brendshme ofroi një shpërblim për çdo informacion që çonte në kapjen e tij. Ai tani pritet të zhvendoset në një burg të sigurisë maksimale. Ndërsa Aleksandri ishte i lirë, vëllai i tij Giancarlo u arrestua dhe u hetua me dyshimin se kishte bashkëpunuar me binjakun e tij. Por ai nuk u akuzua dhe tani është lënë i lirë.

1894 - Trupat britanik okupojnë Ilorinin, Bregun e Artë.
1899 - Kryetari i Francës, Félix Faure vdes derisa ishte në post.
1909 - Serbia mobilizohet kundër Austro-Hungarisë.
1913 - Kryetari Taft pajtohet që të mos intervenojë në Meksiko.
1916 - Trupat ruse okupojnë Erzurumin në Armeni.
1917 - Hapet Sinagoga e parë në Madrid pas 425 viteve.
1918 - Lituania shpall pavarësinë nga Rusia dhe Gjermania.
1923 - Howard Carter zbulon Faraonin Tutankamon.
1927 - SHBA rregullon marrëdhëniet diplomatike me Turqinë.
1959 - Fidel Castro emëron veten Kryeministër të Kubës pasi të dëbon Batistan.
1989 - Egjipti, Iraku, Jordani dhe Jemeni Verior formojnë tregun e përbashkët.

Fejsbuku po na bën të palumtur dhe po i bën njerëzit që vuajnë prej "zilisë së Fejsbukut", të zhyten në depresion, sipas një studimi të fundit. Përdoruesit që morën një javë pushim nga media sociale ishin shumë më të kënaqur me jetën, dhe e renditën më lart mirëqenien e tyre. Eksperimenti i Universitetit të Kopenhagës përfshiu 1095 njerëz, gjysmës së të cilëve iu kërkua të vazhdojnë zakonet e tyre të përdorimit të Fejsbukut, dhe gjysmës që të mos futeshin fare. Ata që pranorin se vuanin nga nivele të larta të zilisë së Fejsbukut, tendenca për të qenë xhelozë nga veprimtaria e miqve në mediat sociale, përfituan më shumë nga ky largim prej Fejsbukut.



PROFESORI I KIMISË

Në Gjakovë, një profesor kimie pyet nxënësit:
- Nëse do të fus orën time të dorës në këtë enën e mbushur me elementë kimikë, si mendoni ju, do shkrijë?
Një nxënës i përgjigjet:
- Jo!
- Shumë mirë, si e nxore këtë konkluzion?
- Shumë e thjeshtë profesor, nëse do shkrihej, ju nuk do e fusnit kurrë orën tuaj të dorës aty brenda!



Shumë prej atyre që dështuan në jetë, janë njerëz që nuk e dinin sa pranë suksesit ishin, në momentin kur hoqën dorë.
(Thomas A. Edison)



KALENDARI HISTORIK 16 SHKURT



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS